

Banka e Tiranës SHA
Raporti i Audituesit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare në datën dhe për
vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

Tabela e Përmbajtjes

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	1
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE	4
1. INFORMACIONI MBI BANKËN	5
2. DEKLARATA E PERPUTHSHMERISE	5
3. PARAQITJA E PASQYRAVE FINANCIARE	5
4. BAZAT E PËRGATITJES	6
5. NDRYSHIME NË POLITIKAT KONTABËL DHE SHËNIMET SHPJEGUESE	6
6. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT	7
7. STANDARDE TË PUBLIKUARA, POR ENDE JO EFEKTIVE	19
8. GJYKIME, VLERËSIME DHE SUPOZIME TË RËNDËSISHME TË KONTABËL	20
9. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR	22
10. TË ARDHURAT NGA INTERESI DHE TË NGJASHME	52
11. SHPENZIMET NGA INTERESI DHE TE NGJASHME	52
12. TË ARDHURAT NETO NGA TARIFAT DHE KOMISIONET	52
13. HUMBJET TË PRITSHME NGA ZHVLERËSIMI / (RIKUPERIMI) I PARADHËNIEVE NDAJ BANKAVE, LETRAVE ME VLERË DHE ZËRAVE JASHTË BILANCIT	52
14. SHPENZIME PERSONELI	52
15. SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE	53
16. TATIMI MBI FITIMIN	53
17. TE ARDHURA TE TJERA, NETO	54
18. MJETET MONETARE DHE LLOGARITË ME BANKËN QENDRORE	55
19. DEPOZITA DHE LLOGARI ME BANKAT	56
20. HUATË DHE PARADHËNIET PËR KLIENTËT, NETO	58
21. AKTIVE FINANCIARE ME VLERËN E DREJTË PËRMES TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	68
22. AKTIVE FINANCIARE ME KOSTO TË AMORTIZUAR	71
23. AKTIVE TË RIPOSEDUARA, NETO	73
24. AKTIVE JOMATERIALE	73
25. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE DHE AKTIVE ME TË DREJTË PËRDORIMI	74
26. AKTIVE TË TJERA	75
27. DETYRIME NDAJ BANKAVE	75
28. DETYRIME NDAJ KLIENTËVE	75
29. BORXHI I VARUR	76
30. DETYRIME TË TJERA	76
31. PROVIZIONET	76
32. KAPITALI I PAGUAR DHE PRIMI I AKSIONIT	77
33. INFORMACION SHITESË PËR FLUKSET E PARASË	77
34. PALËT E LIDHURA	78
35. PARAQITJA E INSTRUMENTEVE FINANCIARE SIPAS KATEGORISË SË MATJES	79
36. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA	80
37. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT	82

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarin e Banka e Tiranës sh.a

Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të veçanta të Banka e Tiranës sh.a (më poshtë "Banka"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2021, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të veçanta të paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2021, dhe performancën financiare dhe flukseve të parasë për vitin e mbyllur më atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

Baza për opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) ("Kodi i BSNEPK") dhe me me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë ("Kodi IEKA"), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", të ndryshuar, që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK dhe Kodin IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera të Përfshira në Raportin Vjetor 2021 të Banka e Tiranës sh.a.

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin Vjetor të Bankës për vitin 2021, përgatitur në përputhje me nenet 17 dhe 19 të Ligjit Nr. 25\2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Bankës për vitin 2021 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lartë kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomalitë materiale.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionit mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Bankës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Bankës të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Banka e Tiranës sh.a, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri

Ernst & Young Certified Auditors
27 prill 2022
Tiranë, Shqipëri



Mario Vangjel
Auditues Ligjor

Mario Vangjel

Tirana Bank SHA*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhurat nga interesi dhe të ngjashme	10	3,176,083	2,855,140
Shpenzimet nga interesi dhe të ngjashme	11	(283,345)	(250,908)
Të ardhura neto nga Interesat		2,892,738	2,604,232
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet	12	517,792	488,892
Shpenzime për tarifat dhe komisionet	12	(28,026)	(18,944)
Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet		489,766	469,948
Humbjet të pritshme nga zhvlerësimi i huave dhe paradhënieve për klientët	20	(84,037)	(603,715)
Humbjet të pritshme nga zhvlerësimi / rikuperimi i paradhënieve ndaj Bankave, letrave me vlerë dhe zërave jashtë bilancit	13	(8,066)	227,500
Totali nga humbjet e pritshme nga huatë		(92,103)	(376,215)
Të ardhura të tjera, neto	17	232,955	203,107
Fitime/(humbje) nga kursi i kembimit		(46,205)	233,425
Shpenzime personeli	14	(794,050)	(700,460)
Zhvlerësimi i aktiveve të riposeduara	23	(122,127)	(226,168)
Provizione të tjera		(54,552)	(11,718)
Amortizimi i aktivitet jo-material	24	(102,766)	(77,546)
Zhvlerësimi i pasurive, pajisjeve dhe aktiveve me të drejtë përdorimi	25		(289,357)
Shpenzime të tjera operative	15	(1,002,243)	(1,004,359)
		(2,213,730)	(1,873,076)
Fitimi përpara tatimit mbi të ardhurat		1,076,670	824,889
Shpenzime për tatimin mbi të ardhurat	16	(211,641)	(176,621)
Fitimi për vitin		865,029	648,268
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:			
Zëra që mund të riklasifikohen më vonë në fitim/humbje:			
- Humbja neto nga vlera e drejtë e aktivitet financiarë VDATGJ	21	(24,951)	(395,211)
- Tatimi i shtyrë në lidhje me fitimin e vlerës së drejtë i regjistruar direkt në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	16	5,125	59,290
Të ardhura /(shpenzime) të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		(19,826)	(335,921)
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		845,203	312,347

Pasqyrat financiare u miratuan nga Drejtimi i Bankës më 30 mars 2022 dhe u nënshkruan në emër të tyre nga:

Dritan Mustafa

Drejtör i Përgjithshëm Ekzekutiv



Elvira Kapoli

Drejtuese Financiare

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet bashkë me shënimet shoqëruese nga faqja 5 deri në 82 të cilat janë pjesë integrale e pasqyrave financiare.

Tirana Bank SHA

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

më 31 dhjetor 2021

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
AKTIVET			
Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qëndrore	18	8,808,519	6,972,818
Depozita dhe llogari me bankat	19	3,400,028	5,817,178
Huatë dhe paradhënie për klientët, neto	20	44,808,715	37,991,132
Aktivitet financiar me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	21	30,807,125	26,434,010
Aktivitet financiar me kosto të amortizuar	22	5,587,591	3,594,101
Aktive të riposeduara, neto	23	1,536,400	1,943,532
Aktive të tjera	26	700,254	489,177
Aktive jo-materiale	24	401,534	343,595
Aktive afatgjata materiale dhe aktive me të drejtë përdorimi	25	1,004,452	791,356
Aktive tatimore të shtyra	16	22,952	13,995
TOTALI I AKTIVEVE		97,077,570	84,390,894
DETYRIMET			
Detyrime ndaj bankave	27	890,898	1,860,698
Detyrime ndaj klientëve	28	82,410,517	71,569,313
Borxhi i varur	29	607,176	-
Detyrime të tjera	30	2,106,195	732,202
Provizione	31	233,300	243,899
TOTALI I DETYRIMEVE		86,248,086	74,406,112
Kapitali			
Kapitali i paguar	32	5,917,986	5,917,986
Primi i aksioneve	32	1,735,494	1,735,494
Rezervat	32	1,768,685	1,756,097
Fitimi i pashpërdara		1,407,319	575,205
TOTALI I KAPITALIT		10,829,484	9,984,782
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		97,077,570	84,390,894

Pasqyrat financiare u miratuan nga Drejtimi i Bankës më 30 mars 2022 dhe u nënshkruan në emër të tyre nga:


Dritan Mustafa
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv




Elvira Kapoli
Drejtuese Financiare

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet bashkë me shënimet shoqëruese nga faqja 5 deri në 82 të cilat janë pjesë integrale e pasqyrave financiare.

Tirana Bank SHA*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL**

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

	Kapitali i paguar	Primi i aksioneve	Rezerva ligjore dhe rezerva të tjera	Rezerva e vlerës së drejtë	(Humbjet) akumuluar// fitimi i pashpërndarë	Totali i kapitalit
Më 1 janar 2020	11,161,303	1,735,494	1,374,250	697,726	(5,296,338)	9,672,435
Transaksioni me pronarët i regjistruar direkt në kapital						
Përvetësimi i fitimeve të mbajtura ndaj rezervave ligjore	-	-	20,042	-	(20,042)	-
Ndryshime në kapitalin aksionar nga shkrirja e humbjeve të akumuluar	(5,243,317)	-	-	-	5,243,317	-
	5,917,986	1,735,494	1,394,292	697,726	(73,063)	9,672,435
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin						
Fitimi i vitit	-	-	-	-	648,268	648,268
Ndryshimi neto në Rezervat e Aktiveve financiare në VDATGJ	-	-	-	(335,921)	-	(335,921)
Të ardhurat totale gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	(335,921)	648,268	312,347
Më 31 dhjetor 2020	5,917,986	1,735,494	1,394,292	361,805	575,205	9,984,782
Transaksioni me pronarët i regjistruar direkt në kapital						
Përvetësimi i fitimeve të mbajtura ndaj rezervave ligjore	-	-	32,413	-	(32,413)	-
	5,917,986	1,735,494	1,426,705	361,805	542,791	9,984,782
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin						
Fitimi i vitit	-	-	-	-	865,029	865,029
Ndryshimi neto në Rezervat e Aktiveve financiare në VDATGJ	-	-	-	(19,826)	-	(19,826)
Të ardhurat totale gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	(19,826)	865,029	845,203
Më 31 dhjetor 2021	5,917,986	1,735,494	1,426,705	341,979	1,407,820	10,829,484

Pasqyrat financiare u miratuan nga Drejtimi i Bankës më 30 Mars 2022 dhe u nënshkruan në emër të tyre nga:

Dritan Mustafa
Drejtor i Përgjithshëm EkzekutivElvira Kapoli
Drejtuese Financiare

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet bashkë me shënime shpjeguese nga faqja 5 deri në 82 të cilat janë pjesë integrale e pasqyrave financiare.

Tirana Bank SHA

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

	Shënime	2021	2020
AKTIVITETE OPERATIVE:			
Fitimi përpara tatimit		1,076,670	824,889
Rregullime për rikonsilimin e fitimit neto me mjetet monetare të siguruar nga aktivitetet operative:			
Shpenzime amortizimi	24,25	427,509	366,904
Zhvlërësimi i pronave të riposeduara	23	3,313	145,513
(Rimarrje) zhvlërësim për provizione të humbjet e kredisë	20	(82,935)	511,201
Zhvlërësim/(rimarrje) për provizioneve të tjera		62,618	(218,335)
Të ardhura nga interesi	10	(3,176,083)	(2,855,140)
Shpenzime interesi	11	283,345	250,908
Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operative			
Rezerva të detyrueshme		(1,085,859)	(339,847)
Depozita dhe llogari ndaj bankave		16	(166)
Huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve		(6,720,971)	(7,313,187)
Aktive të tjera		(211,077)	150,108
Aktive të riposeduara		403,819	(579,443)
Detyrime ndaj bankave		(971,407)	(156,373)
Detyrime ndaj klientëve		10,826,454	8,253,326
Detyrime të tjera		1,220,091	(116,833)
Interes i arkëtuar		3,002,515	2,745,871
Interesi i paguar		(263,613)	(259,847)
Tatimi i paguar mbi të ardhurat		(211,640)	(176,205)
Flukse të mjeteve monetare neto nga aktivitetet operative		4,582,765	1,233,344
AKTIVITETE INVESTUESE:			
Blerjet e letrave me vlerë të investimit		(12,558,938)	(17,141,729)
Të ardhurat nga maturimi/shitja e letrave me vlerë		6,228,800	18,010,115
Të ardhura/(humbje) nga shitja e pronave		81,055	(47,399)
Blerja e aktiveve jo-materiale		(320,546)	(263,136)
Blerja e pronave dhe pajisjeve		(459,051)	(248,877)
Flukse të mjeteve monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetet investues		(7,028,680)	308,975
AKTIVITETE FINANCUESE:			
Leshimi i borxhit të varur	33	603,800	-
Shlyerja e principalit të detyrimeve të qirase		175,355	144,468
Flukse të mjeteve monetare neto për aktivitetet financuese		779,155	144,468
Rënie në flukset e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e tyre		(1,666,760)	1,686,786
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre, fillimi i viti		7,407,770	5,720,984
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre, në fund të vitit	33	5,741,010	7,407,770

Pasqyrat financiare u miratuan nga Drejtimi i Bankës më 30 Mars 2022 dhe u nënshkruan në emër të tyre nga:

Dritan Mustafa
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv



Elvira Kapoli
Drejtuese Financiare

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet bashkë me shënimet shoqëruese nga faqja 5 deri në 82 të cilat janë pjesë integrale e pasqyrave financiare

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

1. Informacioni mbi Bankën

Tirana Bank SHA ("Banka"), u themelua në 1996 për të operuar në të gjitha fushat e aktivitetit bankar me pakicë në Shqipëri. Bazuar në nenin 4 të Statutit të Bankës, objektivi i Bankës është të veprojë, në favor të saj apo të palëve të treta, çfarëdo dhe çdo operacion të pranuar apo të deleguar Bankës sipas legjislacionit përkatës. Aktiviteti kryesor i Bankës konsiston në operacione bankare dhe financiare, bazuar në një licencë të plotë bankare të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

Licenca është lëshuar në përputhje me Ligjin nr. 8365, "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", datë 2 Korrik 1998, i cili është zëvendësuar nga Ligji nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar. Banka është gjithashtu subjekt i Ligjit nr. 9901, datë 14 Prill 2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ndryshuar, si edhe ligje të tjera.

Në 11 nëntor 2020, pronësia e bankës ka ndryshuar dhe bazuar në Marrëveshjen e Shitblerjes, të gjitha aksionet e zotëruara më parë nga Komercjalna Banka AD Shkup janë blerë plotësisht nga Balfin SHPK.

Më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 Struktura e aksionarëve të Tirana Bank SHA paraqitet si më poshtë:

Aksionari	Aksione	Në %
Balfin shpk	501.975	100%
Totali	501.975	100%

Më 31 dhjetor 2021 Banka ka 35 degë (2020: 35) brenda Republikës së Shqipërisë dhe nuk kryen asnjë aktivitet jashtë saj.

Adresa e regjistruar e Bankës është Rruga Ibrahim Rugova, Kutia Postare 2400/1, Tiranë, Shqipëri. Më 31 dhjetor 2021 Banka ka 501 punonjës me një mesatare vjetore prej 495 punonjës (më 31 dhjetor 2020: 478 punonjës).

Më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 Komiteti Ekzekutiv përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

Dritan Mustafa	Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
Elvira Kapoli	Drejtuese Finance
Eralda Tafaj	Drejtuese e Operacioneve
Elona Gjipali	Drejtoresh e Divizionit të Rikuperimit Bankar
Manjola Capo	Drejtoresh e Divizionit të Kredisë
Lila Canaj	Drejtuese e Retail
Glenda Kurti	Drejtoresh e Divizionit të Korporatave

Aktiviteti kryesor

Aktiviteti kryesor i biznesit të Bankës është veprimtaria bankare tregtare dhe me pakicë brenda Republikës së Shqipërisë. Banka funksionon në sajë të një licence të plotë bankare të lëshuar nga Banka Qendrore e Republikës së Shqipërisë ("Banka e Shqipërisë" ose "BSH") që prej vitit 1996.

2. Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të Bankës janë pergatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

Politikat kontabël të miratuara janë në përputhje me ato të vitit të kaluar financiar.

3. Paraqitja e pasqyrave financiare

Banka e ka paraqitur pasqyrën e pozicionit të saj financiar në shifra të përafërta të likuiditetit bazuar në qëllimin dhe aftësinë e perceptuar të Bankës për të rikuperuar/ shlyer pjesën më të madhe të aktiveve/detyrimeve të nënzhërit përkatës të pasqyrave financiare.

Aktivitetet dhe detyrimet financiare në përgjithësi raportohen bruto në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar, përveç kur janë përmbushur kriteret e netimit të SNRF-ve.

3.1 Vlerat e krahasueshme

Riklasifikimi është bërë me qëllim që të sigurohet një paraqitje më e mirë në pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020.

Më konkretisht, "Rikuperimet nga huatë e fshira më parë" paraqiten në Të Ardhurat e Tjera në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në vend të Humbjeve të pritshme nga zhvlerësimi i huave dhe paradhënies për klientët siç janë paraqitur më 31 dhjetor 2020.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

4. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç aktiveve financiare me vlerën e drejtë përmes investimeve financiare të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse ("VDATGJ") që maten me vlerën e drejtë dhe kolaterale të riposduara të cilat maten në vlerën më të ulët të kostos dhe vlerën neto të realizueshme. Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek Shqiptar dhe të gjitha vlerat janë të rrumbullakosur në mijëshen më të afërt ('000 LEK), nëse nuk shprehet ndryshe.

4.1 Parimi i vijimësisë

Drejtimi i Bankës i përgatiti këto pasqyra financiare mbi bazën e vazhdimësisë. Sipas gjykimeve, drejtimi i Bankës mori parasysh pozicionin financiar të Bankës, synimet aktuale, përfitimin e operacioneve dhe aksesin në burimet financiare. Drejtimi i Bankës ka bërë një vlerësim të aftësisë së Bankës duke u mbështetur në parimin e vijimësisë dhe është i kënaqur që Banka ka burime që të vazhdojë aktivitetin operacional në të ardhmen e parashikueshme. Gjithashtu, Drejtimi nuk është në dijeni të pasigurive të mundshme që mund të hedhin dyshime në aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi.

Pandemia Covid ka kontribuar në këtë situatë të paprecedent në mjedisin e biznesit në Shqipëri. Në përgjigje të kësaj situatë, Banka e Shqipërisë ndërmoi masa të menjëhershme për të mbështetur ekonominë shqiptare dhe miratoi disa masa ndaj bankave tregtare për të kapërcyer këtë situatë me sa më pak efekte negative të mundshme.

Banka e Shqipërisë ka kërkuar konkretisht që Tirana Bank të mbajë një normë minimale të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 15% deri në shkurt 2022 dhe një raport minimal prej 13,5% pas kësaj datë.

Gjithashtu Banka po monitoron situatën aktuale me konfliktin Rusi - Ukrainë dhe ndikimin e saj në ekonomi, veçanërisht në termat e inflacionit. Banka nuk ka asnjë investim direkt të ekspozuar ndaj këtyre vendeve dhe nuk ka klientë të medhenj kreditues që kanë përqëndrime të konsiderueshme biznesi me to, kështu që nuk ka rreziqe të drejtpërdrejta përveç mjedisit të përgjithshëm ekonomik. Banka është përgjigjur me një qasje të matur ndaj ekspozimeve në humbjen e kredisë, dhe rritjes vigjilente ndaj monitorimeve të portofoleve të kredisë. Instrumentet e tjera financiare të mbajtura nga Banka nuk kanë shfaqur ndonjë ekspozim të rëndësishëm në rrezikun e kredisë.

Pavarësisht pandemisë, portofoli i kredive për sa i përket vonesave ka treguar stabilitet krahasuar me fundin e vitit 2020. Një stabilitet i tillë pikaset për linjat kryesore të biznesit dhe brenda portofolit përkatës të prekur nga Covid si dhe ai i përbërë nga huatë që nuk përfitojnë nga shtyrja e afatit. Kategoria e kredive me mbi 90 ditë me vonesë ka pësuar rënie në termat e portofolit të aksioneve të Bankës kundrejt fundit të vitit 2020 dhe e njëjta gjë pikaset dhe për kategorinë 31-90 ditë vonese. Kërkesa e tregut për kredi të reja dhe shërbime bankare rezultojnë të forta. Me lehtësimin e masave kufizuese nga qeveria dhe vaksinimin e popullsisë, ekonomia u përmirësua, duke çuar kështu në një rritje të aktiviteteve bankare dhe një rritje të cilësisë dhe vlerës së aktiveve me interes gjatë vitit 2021, duke çuar në një rritje të të ardhurave neto nga interesi, komisionet dhe reduktimi i provizionit të kredisë krahasuar me vitin 2020. Banka ka arritur të realizojë një nivel të kënaqshëm fitimi dhe ajo ka kapital të mjaftueshëm dhe shtesa likuiditeti për të qëndruar elastike ndaj çdo goditje nga pandemia.

Për këtë arsye, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten mbi parimin e vijimësisë së aktivitetit.

5. Ndryshime në politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese

5.1 Standardet dhe interpretimet e reja dhe të ndryshuara

Standardet e mëposhtme u lëshuan dhe hynë në fuqi për periudhën vjetore duke filluar nga 1 Janari 2021, por nuk kanë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës. Banka ka zbatuar vazhdimisht politikat kontabël siç përcaktohen në Shënimin 6 për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

• Reforma Standarde e Normës së Interesit- Faza 2- SNRF 9, SNRF 7 dhe SNRF 16 (Ndryshimet)

Në gusht 2020, BSNK publikoi Reformën e Standardit të Normës së Interesit - Faza 2, Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16, duke përfunduar punën e tij në përgjigje të reformës IBOR. Ndryshimet ofrojnë lehtësime të përkoshme që trajtojnë efektet e raportimit financiar kur një normë e ofruar ndërbankare (IBOR) zëvendësohet me një normë interesi alternative pa rrezik (RFR). Në veçanti, ndryshimet parashikojnë një lehtësi praktike kur llogariten ndryshimet në bazën për përcaktimin e flukseve monetare kontraktuale të aktiveve dhe detyrimeve financiare, për të kërkuar që norma efektive e interesit të rregullohet, ekuivalente me një lëvizje në një normë interesi të tregut. Gjithashtu, ndryshimet paraqesin lehtësime nga ndërprerja e marrëdhënieve mbrojtëse, duke përfshirë një lehtësim të përkohshëm nga detyrimi për të përmbushur kërkesat veçmas të identifikueshme kur një instrument RFR përcaktohet si një mbrojtje e një komponenti rreziku. Ekzistojnë gjithashtu ndryshime në SNRF 7 Instrumentet Financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese për t'u mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare të kuptojnë efektin e reformës së normës bazë të normës së interesit në instrumentet financiare të një njësie ekonomike dhe strategjinë e menaxhimit të rrezikut. Ndërsa aplikimi është retrospektiv, një njësi ekonomike nuk kërkohet të riparaqesë periudhat e mëparshme. Ndryshimet nuk kanë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***6. Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit**

Politikat kryesore të kontabilitetit të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha vitet e paraqitura, përveç kur citohet ndryshe.

6.1 Konvertimi i monedhës së huaj***Monedha funksionale dhe prezantuese***

Monedha funksionale dhe prezantuese e Bankës është leku shqiptar ("lekë"). Leku është monedha kryesore në mjedisin ekonomik në të cilin Banka operon, Republika e Shqipërisë. Shumat e paraqitura në këto pasqyra financiare janë rrumbullakosur në mijëra më të afërt, përveç kur citohet ndryshe.

Transaksionet dhe Gjendje

Transaksionet në monedha të huaja përkthehen në monedhën përkatëse funksionale të operacionit me kursin e këmbimit në vend në datën e transaksionit.

Aktivitet dhe detyrimet monetare të cilat maten me monedha të huaja janë ri-konvertuar në monedha funksionale me kursin e këmbimit në vend në datën e raportimit. Fitimi ose humbja në valutë në zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe koston e amortizuar në monedhë të huaj të përkthyer me kursin e këmbimit në vend në fund të periudhës.

Aktivitet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj, të cilat maten me kosto historike, konvertohen duke përdorur kurset e këmbimit, në datën e njohjes.

Diferencat në monedhë të huaj që rrjedhin nga përkthimi njihen përgjithësisht në fitim ose humbje, përveç diferencave në monedhë të huaj që rrjedhin nga përkthimi i instrumenteve të kapitalit të disponueshëm për shitje, të cilat njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Normat e aplikueshme të këmbimit (lekë në njësi në valutë të huaj) për monedhat kryesore më 31 Dhjetor 2021 dhe 2020 ishin si më poshtë:

	më 31 dhjetor 2021	më 31 dhjetor 2020
USD	106.54	100.84
EUR	120.76	123.70

6.2 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat njihen në atë masë sa është e mundshme që përfitimet ekonomike të rrjedhin në Bankë dhe të ardhurat mund të maten me besueshmëri. Kriteret specifike të mëposhtme të njohjes gjithashtu duhet të përmbushen përpara se të njihen të ardhurat.

a) Të ardhura dhe shpenzime nga interesat dhe të ngjashme

Të ardhurat nga interesi përfshijnë kuponat e fituar nga investimet me të ardhura të pandryshueshme, çdo zbritje të maturuar dhe primin nga bonot e thesarit me kupon zero të njohura duke u përdorur në fitim ose humbje metodën efektive të normës së interesit dhe të ardhura interesi nga kredi dhe paradhënie. Për të gjithë instrumentet financiare të matur me kosto të amortizuar dhe instrumentet financiare që mbartin interesin, të klasifikuar si investime financiare të vlefshme për shitje, të ardhurat nga interesi ose shpenzimet regjistrohen me normën efektive të interesit, e cila është norma që skanton vlerën aktuale të pagesave ose arkëtimit monetare të ardhshme përgjatë jetës së instrumentit financiar, ose një periudhe më të shkurtër, sipas rastit, me vlerën e mbetur neto të aktivitet ose detyrimit financiar.

Përlllogaritja merr parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar (për shembull, opsionet e parapagimit) dhe përfshin çdo tarifë ose kosto shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt instrumentit dhe janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit, por përjashton humbjet e kredisë në të ardhmen. Vlera kontabël e aktivitet ose detyrimit financiar rregullohet nëse Banka rishikon vlerësimet e saj të pagesave ose të arkëtimit. Vlera kontabël e rregulluar llogaritet duke u bazuar në normën efektive fillestare të interesit dhe ndryshimi në vlerën kontabël regjistrohet si e ardhur ose shpenzim nga interesi. Kur vlera e regjistruar e një aktivi financiar ose një grupi aktivesh të ngjashme financiare është zvogëluar si pasojë e një humbje nga zhvlerësimi, të ardhurat nga interesi vazhdojnë të njihen duke përdorur normën efektive të interesit fillestar të aplikuar në vlerën e re kontabël.

'Kostoja e amortizuar' e një aktivi financiar ose detyrimi financiar është shuma në të cilën aktivi financiar ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare minus ripagimet kryesore, plus ose minus amortizimin kumulativ duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo ndryshimi midis asaj fillestare shuma dhe shuma e maturitetit dhe, për aktivet financiare, të rregulluara për çdo lejim të pritsëm të humbjes së kredisë (ose lejimin e zhvlerësimit para 1 janarit 2018). "Vlera kontabël neto e një aktivi financiar" është kostoja e amortizuar e një aktivi financiar para se të rregullohet çdo zhvlerësim për humbjet e pritura të kredisë.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

6. Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

6.2 Njohja e të ardhurave (vazhdim)

b) Të ardhura nga tarifa dhe komisione

Në përputhje me SNRF 15, të ardhurat nga kontratat me klientët njihen kur Banka ka përbushur detyrimet e saj të performancës duke transferuar shërbimet e premtuara tek klienti. Të ardhurat njihen me një vlerë që reflekton vlerën kontabël që pritet të merret në këmbim.

Banka fiton të ardhura nga tarifa dhe komisione nga një gamë e larmishme shërbimesh që u ofron klientëve të saj. Të ardhurat nga tarifatat mund të ndahen në dy kategoritë e mëposhtme:

i. Të ardhura nga tarifatat për shërbime që ofrohen përgjatë një periudhe kohe të caktuar

Tarifatat e fituara për ofrimin e shërbimeve përgjatë një periudhë kohe maturohen përgjatë asaj periudhe. Këto tarifa përfshijnë tarifa komisioni për mirëmbajtjen e llogarive, tarifa të mirëmbajtjes së kartave dhe shërbimit E-banking. Tarifatat për angazhimin e huasë, për kredi që ka të ngjarë të tërhiqen dhe tarifa të tjera të lidhura me kredinë të cilat shtyhen (së bashku me ndonjë kosto shtesë) dhe njihen si një rregullim i normës efektive të interesit për kredinë.

ii. Të ardhura nga tarifatat për shërbime transaksioni që njihen në një pikë në kohë

Këto tarifa dhe komisione përfshijnë tarifatat e urdhër pagesave dhe urdhër transfertave të klientëve, dhe shërbimet e tjera bankare të ofruara. Këto tarifa ose pjesët përbërëse të tarifave që lidhen me një performancë të caktuar njihen pas kryerjes së shërbimit.

- Tarifatat e huadhënies

Tarifatat e përfshira këtu përfshijnë ndër të tjera tarifatat për shërbimin e një kredie, letërkredie ose garancie bankare.

Të ardhurat dhe shpenzimet e tarifave dhe komisioneve të tjera lindin në shërbimet financiare që operohen nga Banka gjatë aktivitetit të saj dhe njihen kur shërbimi përkatës realizohet ose merret.

c) Të ardhurat nga qiraja

Të ardhurat nga qiraja kontabilizohen në mënyrë lineare përgjatë afatit të qirasë, dhe regjistrohen në fitim ose humbje si të ardhura të tjera operative. Banka nuk ka aktive afatgjatë materiale të investimeve në fund të vitit dhe gjatë periudhës së raportimit.

6.3 Instrumentet financiare- njohja fillestare dhe matja e mëpasshme

a) Data e njohjes

Aktivitet dhe detyrimet financiare, me përjashtim të huave dhe paradhënies për klientët dhe tepricat që i detyrohen klientëve, fillimisht njihen në datën e tregtimit, d.m.th., datën në të cilën Banka bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin tregtime të rregullta, d.m.th., blerje ose shitje të aktiveve financiare që kërkojnë shpërndarjen e aktiveve brenda afatit kohor të vendosur përgjithësisht me rregullore ose konventë në tregun vendas. Huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve njihen kur fondet transferohen në llogaritë e klientëve. Banka njih tepricat ndaj klientëve kur fondet transferohen në Bankë.

b) Matja fillestare e instrumenteve financiare

Klasifikimi i instrumenteve financiare në njohjen fillestare varet nga kushtet e tyre kontraktuale dhe modeli i biznesit për menaxhimin e instrumenteve siç përshkruhet në Shënimin 6.5. Instrumentet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë, me përjashtim të rasteve kur aktivitet dhe detyrimet financiare janë regjistruar në Vlerën e Drejtë nëpërmjet Pasqyrës së Fitimit dhe Humbjes (VDPFH), kostot e transaksionit i shtohen, ose zbriten nga kjo shumë. Llogaritë e arkëtueshme tregtare maten me çmimin e transaksionit. Kur vlera e drejtë e instrumenteve financiare në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit, bankat kontabilizojnë fitimin ose humbjen e Ditës 1, siç përshkruhet më poshtë.

c) Dita 1 fitimi ose humbja

Kur vlera e drejtë e instrumentit ndryshon nga vlera e drejtë në origjinë dhe vlera e drejtë bazohet në një teknikë vlerësimi duke përdorur vetëm hyrjet (inputet) e krahasuara në transaksionet e tregut, Banka njih ndryshimin midis çmimit të transaksionit dhe vlerës së drejtë në të ardhurat neto nga tregtimi. Në këto raste kur vlera e drejtë bazohet në modele për të cilat disa nga inputet nuk janë të krahasueshme, diferenca midis çmimit të transaksionit dhe vlerës së drejtë shtyhet dhe ajo njihet vetëm në fitim ose humbje kur hyrjet (inputet) bëhen të krahasueshme, ose kur instrumenti është çregjistruar.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

6. Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

6.3 Instrumentet financiare - njohja fillestare dhe matja e mëpasshme (vazhdim)

d) Kategoritë e matjes së aktiveve dhe detyrimeve financiare

Banka i klasifikon të gjitha aktivet e saj financiare bazuar në modelin e biznesit për administrimin e aktiveve dhe kushteve kontraktuale të aktivitetit, të matura ose me:

- Koston e amortizuar
- Vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ)

Detyrimet financiare, përveç angazhimeve të kredisë dhe garancive financiare, maten me koston e amortizuar ose në VDPFH kur ato mbahen për tregtim ose aplikohet përcaktimi i vlerës së drejtë. Shihni politikat e kontabilitetit në Shënimin 6.5.

e) Kompensimi i instrumenteve financiare

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto e raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar kur ekziston një e drejtë e zbatueshme me ligj për të kompensuar shumat e njohura dhe ka një qëllim që të shlyhen në bazë neto, ose të realizojnë aktivin dhe të shlyejnë detyrimin njëkohësisht.

f) Mosnjohja (çregjistrimi)

Aktivitet financiare çregjistrohen kur të drejtat kontraktuale për të marrë flukset monetare nga këto aktive kanë pushuar së ekzistuari ose aktivitet janë transferuar dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktiveve janë transferuar gjithashtu (që do të thotë, nëse në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet nuk janë transferuar, Banka teston kontrollin për tu siguruar që përfshirja e vazhdueshme në bazë të çdo pushteti të mbajtur të kontrollit nuk parandalon çregjistrimin). Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato janë shlyer ose në rastin e kundërt shuar, d.m.th. kur detyrimi i specifikuar në kontratë, shkarkohet, anulohet ose skadon.

g) Fshirjet

Banka i fshin aktivitet financiare në tërësinë e tyre ose një pjesë të tyre kur ka ezauruar të gjitha përpjekjet praktike të rimëkëmbjes dhe nuk ka ndonjë pritshmëri të arsyeshme për rimëkëmbje. Kriteret që tregojnë se nuk ka pritshmëri të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë periudhën e dështimit, cilësinë e kolateralit dhe fazat e ndryshme të procedurave të përbarimit. Banka mund të fshijë aktivitet financiare që janë ende subjekt i aktiviteteve përbarimore, por kjo nuk ndikon në të drejtat e saj në procedurat e përbarimit. Banka ende kërkon të rikuperojë të gjitha shumat plotësisht që i takojnë me ligj. Fshirja zvogëlon vlerën kontabël bruto të një aktivitet financiar dhe zbritjen për zhvlerësimin. Çdo rikuperim i mëvonshëm i kreditohet shpenzimit të humbjes së kredisë.

6.4 Përcaktimi i vlerës së drejtë

Për të treguar se si janë nxjerrë vlerat e drejta, instrumentet financiare klasifikohen bazuar në një hierarki të teknikave të vlerësimit, siç përmbledhen më poshtë, në:

- Instrumente financiare të Nivelit 1–Ato instrumente ku hyrjet (Inputet) e përdorura në vlerësim janë çmime të kuotuar të parregulluara nga tregjet aktive për aktive ose detyrime identike në të cilat Banka ka qasje në datën e matjes. Banka i konsideron tregjet si aktive vetëm nëse ka veprimtari të mjaftueshme tregtare në lidhje me vëllimin dhe likuiditetin e aktiveve ose detyrimeve identike dhe kur ka kuota çmimesh detyruese dhe të periudhës së ushtruar, të disponueshme në datën e bilancit. Një instrument financiar vlerësohet i kuotuar në një treg aktiv nëse çmimet e kuotuar janë të disponueshme me lehtësi dhe në mënyrë të rregullt nga një agjenci këmbimi valutor, tregtar, ndërmjetës, grup i industrisë, agjenci shërbimi çmimesh ose agjenci rregullatore, dhe këto çmime përfaqësojnë transaksione të tregut aktual dhe që ndodhin rregullisht mbi bazën e vlerës së tregut. Nëse kriteret e mësipërme nuk përmbushen, tregu vlerësohet si joaktiv. Treguesit e një tregu joaktiv janë kur ka një marzh të gjerë të çmimit të kërkuar dhe ofruar ose një rritje të konsiderueshme të marzhit midis çmimit të kërkuar dhe ofruar ose ka pak transaksione të fundit, një rënie të ndjeshme në vëllimin mesatar të tregtimit ditor të të gjitha aksioneve nën shqyrtim në vend gjatë 5 viteve të fundit, etj.
- Instrumente financiare të Nivelit 2 - Ato instrumente ku hyrjet (inputet) që përdoren për vlerësim dhe janë të konsiderueshme, rrjedhin nga të dhëna të tregut të vëzhguara direkt ose indirekt të disponueshme përgjatë të gjithë periudhës së jetës së këtij instrumenti. Të dhëna të tilla përfshijnë çmime të kuotuar për aktive ose detyrime të ngjashme në tregjet aktive, çmime të kuotuar për instrumente identike në tregjet joaktive dhe të dhëna të mbikëqyrura përveç çmimeve të kuotuar siç janë normat e interesit dhe kurbat e normës së interesit, paqëndrueshmëria e nënkuptuar dhe marzhi i kredisë. Për më tepër, rregullimet mund të kërkohen për gjendjen ose vendndodhjen e aktivitet ose masën në të cilën lidhet me zërat që janë të krahasueshëm me instrumentin e vlerësuar. Sidoqoftë, nëse rregullime të tilla bazohen në inpute të pakontrollueshme të cilat janë domethënëse për tërë matjen, Banka do t'i klasifikojë instrumentet si Nivelit 3.
- Instrumente financiare të Nivelit 3 - Ato instrumente që përmbajnë një ose më shumë të dhëna të pambikëqyrura që janë domethënëse për matjen në tërësi.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

6. Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

6.4 Përcaktimi i vlerës së drejtë (vazhdim)

Për të gjithë instrumentet e tjerë financiarë që nuk janë listuar në një treg aktiv, vlera e drejtë përcaktohet duke përdorur teknika të përshtatshme vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknika të vlerës aktuale neto, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ekzistojnë çmime të mbikëqyrura të tregut të dhe modele të tjera të vlerësimit. Teknika vlerësimi, siç janë modelet skontuara të fluksit monetar dhe modelet e bazuara në transaksionet e kryera në mënyrë të vullnetshme midis palëve të palidhura me njëra-tjetrën ose vlera kontabël neto e të dhënave financiare të investitorëve, përdoren për të matur vlerën e drejtë të instrumenteve të caktuar financiarë për të cilët informacioni mbi çmimet e tregut të jashtëm nuk është i disponueshëm.

Banka vlerëson vlerën kontabël neto në secilën periudhë raportimi mbi bazën e instrumentit me instrument dhe riklasifikon instrumentet kur është e nevojshme, bazuar në faktet në fund të periudhës së raportimit.

6.5 Aktivët dhe detyrimet financiare

i. Matja dhe klasifikimi

Instrumentet financiare klasifikohen sipas rregullave të SNRF 9 bazuar në:

- Modelin e biznesit të Bankës për administrimin e aktivitetit financiar dhe
- Karakteristikat kontraktuale të fluksit të mjeteve monetare (referuar si "Testi SPPI").

Bazuar në kriteret e mësipërme, Banka klasifikon instrumentet financiare në një nga tre kategoritë e mëposhtme: (a) me koston e amortizuar (b) në VDATGJ dhe (c) në VDPFH.

Një aktiv financiar (d.m.th. Detyrim nga Bankat, Kreditë dhe paradhëniet e klientëve dhe investimeve të tjera financiare) matet me koston e amortizuar nëse i plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në VDPFH:

- ai është mbajtur në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e aktiveve për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale; dhe
- kushtet kontraktuale të tij krijojnë data të caktuara për flukset e parave që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të papaguar (SPPI).

Një aktiv financiar matet në VDATGJ vetëm nëse i plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në VDPFH:

- ai është mbajtur në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është si mbajtja e aktiveve për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe shitjen e aktiveve financiare; dhe
- kushtet kontraktuale të tij krijojnë data të caktuara për flukset e parave që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të papaguar.

Të gjitha aktivet financiare që nuk klasifikohen si të matura me koston e amortizuar ose VDATGJ siç përshkruhet më lart, maten në VDPFH. Për më tepër, në njohjen fillestare, Banka mund të përcaktojë në mënyrë të pakthyeshme një aktiv financiar që plotëson kërkesat e tjera që duhet të maten me koston e amortizuar ose në VDATGJ si në VDPFH nëse kjo e eliminon ose zvogëlon ndjeshëm një mospërputhje kontabël që do të lindte ndryshe. Banka nuk ka instrumente VDPFH deri në datën e raportimit.

Sipas SNRF 9, derivativët e përfshira në kontrata ku baza e kontratës është një aktiv financiar në fushën e SNRF 9 nuk qëndrojnë të ndarë. Përkundrazi, instrumenti financiar hibrid vlerësohet si një i tërë për klasifikim.

Banka ka finalizuar modelin e saj të biznesit, si dhe testimin SPPI dhe ka arritur në përfundimin si më poshtë:

✓ **Obligacione dhe portofoli i bonove të thesarit**

Për produktet e thesarit të Bankës (obligacionet dhe bonot e thesarit), modelet e identifikuar të biznesit janë "Mbajtje për mbledhje" dhe "Mbajtje për mbledhje dhe shitje" që kërkojnë matjen me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ) nëse edhe kushtet e Testit SPPI janë përbushur.

Sipas SNRF 9 (4.1.2A), një aktiv financiar do të matet me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

- aktivi financiar mbahet brenda një modeli biznesi, objektivi i të cilit arrihet si nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuale, ashtu edhe nga shitja e aktiveve financiare dhe
- kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar lindin në data të specifikuar të flukseve monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën e principalit të papaguar.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

6. Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

6.5 Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

i. Matja dhe klasifikimi (vazhdim)

✓ Obligacione dhe portofoli i bonove të thesarit (vazhdim)

Vlerësimi i modelit të biznesit

Aktivitetet financiare VDATGJ janë matur më pas në vlerën e drejtë me fitimet dhe humbjet që vijnë si rezultat i ndryshimit në vlerën e drejtë të njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse (ATGJ). Të ardhurat nga interesi dhe fitimet dhe humbjet nga këmbimi valutor njihen në fitim ose humbje në të njëjtën mënyrë si për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar. Llogaritja e HPK për aktivin financiar shpjegohet në shënimin 6.5 ii). Mbi çregjistrimin, fitimet ose humbjet kumulative të njohura më parë në ATGJ janë riklasifikuar nga ATGJ në fitim ose humbje.

Tirana Bank nuk mban portofol të letrave me vlerë për qëllime tregtimi, me qëllimin e blerjes/shitjes në mënyrë aktive në varësi të vlerës së drejtë të aktiveve.

✓ Huatë dhe paradhëniet për klientët

Për huatë dhe paradhëniet e Bankës ndaj portofolit të klientëve, modeli i biznesit i identifikuar është modeli i biznesit "Mbatje për mbledhje" dhe për këtë arsye, huatë e klasifikuara në këtë model biznesi do të maten me kosto të amortizuar nëse plotësohen edhe kushtet e testit VPPI. Çdo hua që do të dështojë në testin VPPI do të matet me vlerën e drejtë përmes FH.

Sipas SNRF 9 (4.1.2), një aktiv financiar matet me koston e amortizuar nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

- aktiviteti financiar mbahet brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukset monetare kontraktuale dhe
- kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar lindin në data të specifikuar të flukseve monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën e principalit të papaguar.

Modeli i biznesit i Bankës është të krijojë kredi dhe të mbledhë flukset e tyre monetare kontraktuale. Çdo shitje e aktiveve financiare brenda këtij modeli biznesi kryhet për shkak të përkeqësimit të kreditimit të huasë dhe me qëllim zvogëlimin e kredive me problem (NPL, NPE) dhe në asnjë rast nuk pasqyron qëllimin fillestar të veprimtarisë së huadhënies.

Vlerësimet nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit

Për qëllime të këtij vlerësimi, "principalit" përkufizohet si vlera e drejtë e aktivitetit financiar në njohjen fillestare. 'Interesi' përcaktohet si vlera kontabël neto për vlerën në kohë të parasë, për rrezikun e kredisë të shoqëruar me shumën e principalit të mbetur papaguar në një periudhë të caktuar kohe dhe për rreziqet dhe kostot e tjera bazë të huazimit (p.sh. rreziku i likuiditetit dhe kostot administrative), si dhe një marzh fitimi.

Në mënyrë që të japë vlerësimin nëse flukset monetare kontraktuale janë pagesa vetëm të principalit dhe interesit, Banka merr në konsideratë kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin vlerësimin nëse aktiviteti financiar përmban një afat kontraktual që mund të ndryshojë kohëzgjatjen ose shumën e flukseve monetare kontraktuale të tillë që të mos mund të plotësojë këtë kusht.

Në bërjen e vlerësimin, Banka konsideron:

- ngjarje të mundshme që mund të ndryshojnë shumën dhe kohëzgjatjen e fluksit të parave;
- karakteristikat e levave;
- afatet zgjatjes dhe parapagimit;
- kushte që kufizojnë pretendimin e Bankës për flukse monetare nga aktive të specifikuar - p.sh. rregullimet e aktiveve pa rekurs; dhe
- tipare që modifikojnë vlerën kontabël neto për vlerën në kohë të parasë - p.sh. rivendosja periodike e normave të interesit.

Normat e interesit në huatë me pakicë të krijuara nga Banka bazohen në Normat e Brendshme që përcaktohen nën diskrecionin e Bankës. Në këto raste, Banka vlerëson nëse seti SFR është në përputhje me normat e tregut dhe i siguron Bankës kthime të mjaftueshme për të mbuluar:

- vlerën në kohë të parasë,
- rrezikun e kredisë të lidhur me shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe kohe të caktuar, dhe
- rreziqe dhe kosto të tjera bazë të huazimit, si dhe një marzh fitimi.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

6. Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

6.5 Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

i. Matja dhe klasifikimi (vazhdim)

✓ Huatë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)

Të gjitha kreditë me pakicë të Bankave përmbajnë veçori të parapagimit. Një tipar parapagimi është në përputhje me kriterin SPPI nëse shuma e parapagimit paraqet në mënyrë thelbësore shuma të papaguara të principalit dhe interesit mbi shumën e principalit të papaguar, e cila mund të përfshijë kompensim të arsyeshëm për ndërprerjen e parakohshme të kontratës.

ii. Zhvlerësimi

Banka ka regjistruar zbritjen e humbjeve të pritshme të kredisë për të gjitha kreditë dhe aktivet e tjera financiare që nuk janë mbajtur në VDPFH, së bashku me angazhimet e kredisë dhe kontratat e garancive financiare. Kjo kërkon vlerësim të ndryshimeve në faktorët ekonomikë që prekin HPK, të cilat përcaktohen në bazë të peshës së ponderuar të probabilitetit.

Përveç Aktiveve Financiare që maten me kosto të amortizuar, modeli i ri i zhvlerësimit zbatohet edhe për instrumentet financiare në vijim që nuk maten me VDPFH:

- aktive financiare që janë instrumente borxhi; dhe
- angazhimet e huave dhe kontratat e garancisë financiare të lëshuara (më parë, zhvlerësimi është matur sipas SNK 37 Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivet e Kushtëzuar).

SNRF 9 kërkon të njihet një humbje e zbritshme në një shumë të barabartë me HPK-të 12-mujore ose HPK-të e përjetshme në varësi të vlerësimit të rrezikut të dështimit. HPK-të e përjetshme janë HPK-të që rezultojnë nga të gjitha rastet e mundshme të dështimit gjatë jetës së pritshme të një instrumenti financiar, ndërsa HPK-të 12-mujore janë pjesë e HPK-ve që rezultojnë nga rastet e dështimit që janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit.

Banka njih humbjet e zbritshme në një shumë të barabartë me HPK-të e përjetshme, përveçse në rastet e mëposhtme, për të cilat shuma e njohur do të jetë HPK 12-mujore:

- letrat me vlerë investuese të borxhit që përcaktohen të kenë rrezik të ulët kreditor në datën e raportimit. Banka e konsideron një letër borxhi si një rrezik i ulët kredie kur vlerësimi i rrezikut të saj kreditor është ekuivalent me përkufizimin e kuptimit global të "klasës së investimit"; dhe
- huatë dhe letrat me vlerë investuese të borxhit për të cilat rreziku kreditor nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, dhe kështu që, ato klasifikohen në Fazën 1.

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 janë komplekse dhe kërkojnë gjykime, vlerësime dhe supozime të drejtimit, veçanërisht në fushat e mëposhtme, të cilat diskutohen më në detaje më poshtë:

- Llogaritja e input-eve kryesore në HPK si Probabiliteti i Dështimit (PD), Humbja në rast Dështimi (HD) dhe Ekspozimi në rast Dështimi (ED).
- vlerësimi nëse rreziku kreditor i një instrumenti është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare; dhe
- përfshirja e informacionit të ardhshëm në matjen e HPK-ve.

HPK-të janë një vlerësim i ponderuar probabiliteti i humbjeve të kredisë dhe do të maten si më poshtë:

- aktive financiare që nuk janë kredituar-zhvlerësuar në datën e raportimit: vlera aktuale e të gjitha mungesave të parave - d.m.th. diferenca midis fluksit të mjeteve monetare që i detyrohen njësisë ekonomike në përputhje me kontratën dhe flukset e mjeteve monetare që Banka pret të marrë;
- aktivet financiare që janë zhvlerësuar nga kreditë në datën e raportimit: diferenca midis vlerës kontabël bruto dhe vlerës aktuale të fluksit monetare të ardhshme të vlerësuar;
- angazhimet e huasë të patërhequr: vlera aktuale e diferencës midis flukseve të mjeteve monetare kontraktuale që i detyrohen Bankës nëse angazhimi dhe flukset monetare që Banka pret të marrë tërhiqen; dhe
- kontratat e garancisë financiare: vlera aktuale e pagesave të pritshme për të rimbursuar mbajtësin minus shumat që Banka pret të rikuperojë.

• Të dhënat (Input-e) në matjen e HPK-ve

Të dhënat (inputet) kryesore në matjen e HPK-ve kanë të ngjarë të jenë struktura afatgjata të variablave në vijim: Probabiliteti i Dështimit (PD), Humbja në rast Dështimi (HD) dhe Ekspozimi në rast Dështimi (ED).

Këto parametra rrjedhin nga modelet statistikore të zhvilluara nga brenda dhe të dhëna të tjera historike. Ato janë të përshtatura për të pasqyruar informacionin e ardhshëm siç përshkruhet më poshtë.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

6. Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

6.5 Aktivitet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

ii. Zhvlerësimi (vazhdim)

• Të dhënat (Input-e) në matjen e HPK-ve (vazhdim)

Nivelet e rrezikut kreditor do të jenë një kontribut primar në përcaktimin e strukturës afatgjatë të Probabilitetit të Dështimit për ekspozimet. Banka do të përdorë modele statistikore për të analizuar të dhënat e mbledhura dhe për të gjeneruar vlerësime të Probabilitetit të Dështimit së mbetur të ekspozimeve dhe se si këto pritet të ndryshojnë si pasojë e kalimit të kohës. Kjo analizë do të përfshijë identifikimin dhe kalibrimin e marrëdhënieve midis ndryshimeve në normat e Dështimit dhe ndryshimeve në faktorët kryesorë makroekonomikë. Për shumicën e ekspozimeve, treguesit kryesorë makroekonomikë ka të ngjarë të përfshijnë rritjen e PBB-së, normat e interesit dhe papunësinë. Qasja e Bankës për përfshirjen e informacioneve të ardhshme në këtë vlerësim është diskutuar më poshtë.

- Humbja në rast Mospagimi (HM) është madhësia e humbjes së mundshme nëse ka mospagim nga huamarrësi. Banka vlerëson parametrat e Humbjes së Ardhur nga Mospagimi bazuar në historinë e niveleve të rikuperimit të kërkesave ndaj palëve të paracaktuara. Modelet e Humbjes së Ardhur nga Mospagimi marrin në konsideratë strukturën, kolateralin, vjetërsinë e kërkesës dhe kostot e rikuperimit të çdo kolaterali që është pjesë përbërëse e aktivitetit financiar.
- Ekspozimi në rast Mospagimi (EM) përfaqëson ekspozimin e pritshëm në rast të një mospagimi. Ekspozimi në Mospagim i një aktivi financiar do të jetë vlera kontabël bruto në mospagim. Për angazhimet e huadhënies dhe garancitë financiare, Ekspozimi në Mospagim do të marrë parasysh shumën e tërhequr, si dhe shumat potenciale të ardhshme që mund të nxirren ose paguhen sipas kontratës, të cilat do të vlerësohen bazuar në vrojtimet historike dhe parashikimet e ardhshme.

Banka mat HPK-të duke marrë parasysh rrezikun e Dështimit për periudhën maksimale kontraktuale (përfshirë opsionet e zgjatjes së kredisë së huamarrësit) mbi të cilat është e ekspozuar ndaj rrezikut kreditor. Periudha maksimale kontraktuale zgjat deri në datën në të cilën Banka ka të drejtë të kërkojë një pagesë paradhënie ose ndërpresë një angazhim ose garanci kredie.

Për overdraftet me pakicë dhe lehtësirat e kartës së kreditit dhe disa struktura rrotulluese të korporatave që përfshijnë si një hua dhe një përbërës të angazhimit të patërhequr, Banka mund të matë HPK-të për një periudhë më të gjatë se periudha maksimale kontraktuale, nëse aftësia kontraktuale e Bankës për të kërkuar ripagimin dhe anulimin e angazhimit të patërhequr nuk kufizon ekspozimin e Bankës ndaj humbjeve të kredisë në periudhën e njoftimit kontraktual. Këto lehtësira nuk kanë një afat të caktuar ose strukturë të ripagimit dhe menaxhohen në baza kolektive. Banka mund t'i anulojë ato me efekt të menjëhershëm, por kjo e drejtë kontraktuale nuk zbatohet në menaxhimin normal të përditshëm, por vetëm kur Banka vihet në dijeni për një rritje të rrezikut kreditor. Megjithatë, kjo periudhë do të vlerësohet duke marrë parasysh veprimet e menaxhimit të riskut kreditor që Banka pret të ndër marrë dhe që shërbejnë për të zbutur HPK-të. Këto përfshijnë një ulje të limiteve dhe anulimin e lehtësirave që Banka ofron.

Kur modelimi i një parametri kryhet në bazë kolektive, instrumentet financiare do të grupohen në bazë të karakteristikave të rrezikut të përbashkët që përfshijnë:

- llojin e instrumentit/klentit; dhe
- klasifikimin i rrezikut kreditor.

Grupimet do t'i nënshtrohen rishikimit të rregullt për të siguruar që ekspozimet brenda një grupi të caktuar të mbeten në mënyrë të përshtatshme homogjene.

Për investimet në letrat me vlerë të borxhit, në lidhje me të cilat Banka ka të dhëna historike të kufizuara, informacionet e jashtme referuese të publikuara nga agjencitë e njohura të vlerësimit të jashtëm të kredive si Moody's do të përdoren për të plotësuar të dhënat në dispozicion brenda vendit.

Përkufizimi i dështimit

Sipas SNRF 9, Banka e konsideron një aktiv financiar si të papaguar kur:

- huamarrësi nuk ka gjasa të paguajë plotësisht detyrimet e tij të kredisë ndaj Bankës, pa ndërhyrjen nga ana e Bankës me veprime të tilla si realizimi i sigurisë (nëse ka mbajtje të tilla); ose
- huamarrësi ka më shumë se 90 ditë pa i paguar një detyrim material kredie Bankës.

Ky përkufizim është kryesisht në përputhje me përkufizimin e përdorur për qëllime rregullatore për kreditë e klasifikuara si nënstandard, të dyshimta ose të humbura.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

6. Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

6.5 Aktivitet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

ii. Zhvlerësimi (vazhdim)

- **Të dhënat (Input-e) në matjen e HPK-ve (vazhdim)**

Përkufizimi i dështimit

Sipas SNRF 9, Banka e konsideron një aktiv financiar si të papaguar kur:

- huamarrësi nuk ka gjasa të paguajë plotësisht detyrimet e tij të kredisë ndaj Bankës, pa ndërhyrjen nga ana e Bankës me veprime të tilla si realizimi i sigurisë (nëse ka mbajtje të tilla); ose
- huamarrësi ka më shumë se 90 ditë pa i paguar një detyrim material kredie Bankës.

Ky përkufizim është kryesisht në përputhje me përkufizimin e përdorur për qëllime rregullatore për kreditë e klasifikuara si nënstandard, të dyshimta ose të humbura.

Identifikimi i karakteristikave të mëposhtme rezulton si mospagim.

- a) Ditët e kaluara të pagesës. Ekspozimet më shumë se 90 ditë me vonesë në datën e raportimit (duke përdorur efektin e tërheqjes prej 20% - në nivelin e debitorit).
- b) Vështirësia për të paguar
- c) Aktivi i zhvlerësuar i kredisë siç përcaktohet në kërkesat e SNRF 9
- d) Ekspozime jo performuese të modifikuara
- e) Ekspozime performuese të modifikuara gjatë periudhës së provës (24 muaj pas periudhës së kurimit) për të cilat masat e modifikuara janë zgjatur ose kanë më shumë se 90 ditë vonese.

Inputet e përdorura për të vlerësuar në se një instrument financiar kategorizohet në mospagim, si dhe rëndësia e tyre mund të ndryshojë me kalimin e kohës për të pasqyruar ndryshimet në rrethana.

Nivelet e rrezikut të kredisë

Banka shpërndan çdo ekspozim të biznesit me një shkallë rreziku të kredisë bazuar në kërkesat e përcaktuara nga rregullorja e Administrimit të Riskut të Kredisë, duke përdorur faktorë cilësor dhe sasior që janë tregues të rrezikut të dështimit. Përveç klasave të rrezikut të paraqitura për qëllime rregullatore, Banka identifikon dhe monitoron veçmas kreditë standarde të paguara me vonesë nga kreditë standarde jo të paguara me vonesë.

Çdo ekspozim biznesi është shpërndarë në një shkallë të rrezikut të kredisë në njohjen fillestare bazuar në informacionin e disponueshëm në lidhje me huamarrësit. Ekspozimet i nënshtrohen një monitorimi të vazhdueshëm, i cili mund të rezultojë në një ekspozim të zhvendosur në një shkallë të ndryshme të rrezikut të kredisë.

- **Përcaktimi nëse rreziku kreditor është rritur ndjeshëm**

Sipas SNRF 9, kur përcaktohet nëse rreziku kreditor (për shembull rreziku i dështimit) të një instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, Banka do të marrë parasysh informacione të arsyeshme dhe të mbështetura që janë relevante dhe të disponueshme, pa kosto dhe përpjekje të panevojshme, duke përfshirë informacionin cilësor dhe sasior dhe analizën bazuar në përvojën historike të Bankës, vlerësimin e ekspertëve të kredive dhe informacionin e ardhshëm.

Banka merr në konsideratë si kriteret sasiorë ashtu edhe cilësorë në mënyrë që të vlerësojë nëse ka ndodhur një rritje e konsiderueshme e rrezikut kreditor.

Elementi sasior llogaritet bazuar në ndryshimin e probabilitetit të dështimit për të gjithë jetën duke krahasuar:

- Probabilitetin e dështimit në datën e raportimit; me
- Probabilitetin e dështimit që u vlerësua bazuar në fakte dhe rrethana në kohën e njohjes fillestare të ekspozimit

Banka përcakton kriteret për rritjen sasiorë relative të probabilitetit të dështimit që janë tregues i një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë.

Banka ka vendosur tre lloje treguesish: a) primar, b) sekondar dhe c) ndalesa për të demonstruar prioritetin e treguesve të përdorur për të vlerësuar nëse ka ndodhur një rritje e konsiderueshme e rrezikut të kredisë. Pavarësisht prioritetit të tyre, të gjithë kriteret kanë të njëjtën peshë në procesin e vlerësimit për rritje të ndjeshme të rrezikut kreditor.

Treguesit primarë ose sekondarë mund të ndryshojnë për secilin portofol dhe përfshijnë, por pa u kufizuar në ndryshimet relative në jetëgjatësinë e probabilitetit të dështimit ndryshimet e vlerësimit të brendshëm/te jashtëm në nivele, ditë maksimale të vonuara përgjatë 6 muajve të fundit, aktivitetet e modifikuara, ndërsa treguesi i ndaluar është i pranishëm në kushtet e mëposhtme:

- Instrumente që kanë kaluar më shumë se 30 ditë

Të gjitha kreditë që tregojnë rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë klasifikohen në fazën 2.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

6. Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

6.5 Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

ii. Zhvlerësimi (vazhdim)

- Përcaktimi nëse rreziku kreditor është rritur ndjeshëm (vazhdim)

Banka monitoron efektivitetin e kritereve të përdorura për të identifikuar rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë me rishikime të rregullta për të konfirmuar se:

- kriteret janë në gjendje të identifikojnë rritje të ndjeshme në riskun kreditor para se një ekspozim të jetë në mospagim;
- koha mesatare midis identifikimit të një rritjeje të konsiderueshme të riskut kreditor dhe dështimit duket e arsyeshme; dhe
- ekspozimet në përgjithësi nuk transferohen drejtpërdrejt nga matjet e HPK-ve 12-mujore të kredia e zhvlerësuar

Aktivitetet financiare të mbajtura dhe të modifikuara

Kushtet kontraktuale të një kredie mund të modifikohen për një numër arsyesh, duke përfshirë ndryshimin e kushteve të tregut, mbajtjen e klientit dhe faktorë të tjerë që nuk lidhen me një përkeqësim të kredisë aktuale ose të mundshme të klientit. Një kredi ekzistuese, kushtet e të cilës janë modifikuar mund të çregjistrohen dhe kredia e rinegociuar të njihet si një kredi e re me vlerën e drejtë.

Sipas SNRF 9, kur kushtet e një aktivi financiar modifikohen dhe modifikimi nuk rezulton në çregjistrim, Banka shqyrton nëse rreziku i kredisë së aktivitetit është rritur ndjeshëm duke analizuar faktorët sasiorë dhe cilësor që ndikojnë në rrezikun e dështimit.

Banka rinegocion huatë për klientët në vështirësi financiare (të referuara si “aktivitete modifikuese”) për të rritur mundësitë e grumbullimit dhe për të minimizuar rrezikun e dështimit. Sipas politikës së modifikimeve të Bankës, modifikimi i huasë jepet në baza selektive nëse debitori momentalisht është në mospagim të borxhit të tij ose nëse ekziston një rrezik i lartë i dështimit, ka dëshmi se debitori ka bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të paguar sipas kushteve të kontratës fillestare dhe debitori pritet të jetë në gjendje të përmbushë kushtet e rishikuara.

Kushtet e rishikuara zakonisht përfshijnë zgjatjen e maturitetit, ndryshimin e kohës së pagesave të interesit dhe ndryshimin e kushteve të marrëveshjeve të huasë. Të dyja kreditë e tregtueshme dhe të biznesit janë subjekt i politikës së modifikimit.

Në përgjithësi, modifikimi është një tregues cilësor i vonësës dhe zhvlerësimit të kredisë dhe pritshmëritë ndaj modifikimeve janë të rëndësishme për të vlerësuar nëse ka një rritje të konsiderueshme të kredisë. Pas modifikimit, një klient duhet të tregojë sjellje të mirë të pagesave të vazhdueshme gjatë njëzetekatër muajve përpara se ekspozimi të matet në një shumë të barabartë me HPK-të 12-mujore.

Informacionet e ardhshme

Sipas SNRF 9, Banka do të inkorporojë informacione të ardhshme në të dyja vlerësimet e saj nëse rreziku kreditor i një instrumenti është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare dhe matjen e HPK-ve. Banka do të formulojë një skenar bazë për drejtimin e ardhshëm të variablave përkatës ekonomike dhe një gamë përfaqësuese të skenarëve të tjerë të mundshëm të parashikimit dhe shqyrtimin e një sërë informacionesh të jashtme aktuale dhe parashikuese.

Ky proces përfshin zhvillimin e dy ose më shumë skenarëve ekonomikë shtesë dhe duke marrë parasysh probabilitetin relativ të secilit rezultat. Informacioni i jashtëm mund të përfshijë të dhëna ekonomike dhe parashikime të publikuara nga organet qeveritare dhe autoritetet monetare në vendet ku Banka operon, organizata ndërkombëtare, siç janë Komisioni Evropian dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, dhe sektori privat dhe parashikuesit akademikë të zgjedhur.

Rasti bazë paraqet një rezultat më të mundshëm dhe do të përafrohet me informacionin e përdorur nga Banka për qëllime të tjera, siç është planifikimi strategjik dhe buxhetimi. Skenarët e tjerë paraqesin rezultate më optimiste dhe më pesimiste. Banka gjithashtu do të kryejë në mënyrë periodike testimin e stresit të goditjeve më ekstreme për të kalibruar përcaktimin e saj për këto skenarë të tjerë përfaqësues.

Banka ka identifikuar dhe dokumentuar nxitësit kryesorë të rrezikut kreditor dhe humbjeve të kredisë për secilin portofol të instrumenteve financiare dhe, duke përdorur një analizë të të dhënave historike, ka vlerësuar marrëdhëniet midis variablave makro-ekonomike dhe rrezikut të kredisë dhe humbjeve të kredisë. Këta drejtues kryesorë përfshijnë Indeksën e Çmimeve të Konsumit (“IÇK”), shkallën e papunësisë dhe parashikimet e indeksit të Produkteve të Brendshme Bruto (“PBB”). Marrëdhëniet e parashikuara midis treguesve kryesorë dhe niveleve të dështimit dhe humbjeve në portofole të ndryshme të aktiveve financiare janë zhvilluar bazuar në analizën e të dhënave historike gjatë 5 viteve të fundit.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

6. Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

6.6 Aktive të riposeduara

Në rrethana të caktuara, kolaterali rivlerësohet pas konfiskimit të huave që janë në mospagim. Politika e Bankës është të përcaktojë nëse një aktiv i rikuperuar mund të përdoret më së miri për operacionet e saj brendshme apo duhet të shitet. Aktivët e përcaktuara si të dobishme për operacionet e brendshme të Bankës transferohen në kategorinë e tyre përkatëse të aktiveve me vlerën më të ulët të tyre të rivlerësimit ose me vlerën kontabël të aktivit original të siguruar. Aktivët për të cilat shiçja është përcaktuar si opsion më i mirë transferohen si inventarë ("aktive të rivlerësuara") derisa të përmbushen kriteret e njohjes për ta klasifikuar këto aktiv si "të mbajtur për shitje", nga ku ato maten me vlerën e tyre të drejtë (nëse janë aktive financiare) dhe me vlerën e drejtë minus koston e shitjes për tu shitur si aktive jo-financiare në datën e rivlerësimit, në përputhje me politikën e Bankës. Si inventarët, këto aktive maten me koston më të ulët ose vlerën neto të realizueshme (SNK 2.9). Për të përcaktuar nëse vlera neto e realizueshme e këtyre aktiveve ka pësuar rënie nën koston e tyre, Banka mbledh raporte të ndryshme vlerësimi nga disa vlerësues të pavarur dhe regjistron vlerësimet më të ulëta për secilën pronë përkatëse. Çdo rënie nën vlerën neto të realizueshme shfaqet si një shpenzim në periudhën në të cilën ndodh rënia. Çdo përmbysje shfaqet në pasqyrën e fitimit dhe humbjes në periudhën në të cilën ndodh përmbysja.

6.7 Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përbëjnë bilancet e mjeteve monetare dhe depozitat e fondeve të investimit me një maturim origjinal prej tre muajsh ose më pak. Për qëllimin e Pasqyrës së Fluksit Monetar, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbëhen nga mjete monetare në arkë, llogaritë rrjedhëse me Bankën Qendrore dhe shumat që i detyrohen bankat e tjera sipas kërkesës dhe me një maturim fillëstar prej tre muajsh ose më pak nga data e blerjes që janë subjekt i një rreziku të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë, dhe përdoren nga Banka në administrimin e angazhimeve të saj afatshkurtra. Rezerva statutorë pranë Bankës Qendrore nuk është e disponueshme për veprimet ditore të Bankës dhe nuk përfshihet si një përbërës i mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbahen me koston e amortizuar. Detaje të mëtejshme se çfarë përbajnë mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mund të gjenden në Shënimin 33.

6.8 Marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjella të riblerjes

Letrat me vlerë të shitura nën marrëveshje për t'u riblerë në një datë të ardhshme të caktuar nuk çregjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar pasi Banka mban në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit.

Arkëtimet përkatëse të pranuar, përfshirë interesin e përlllogarit, njihen në pasqyrën e pozicionit financiar si "detyrime ndaj bankave", duke pasqyruar thelbin ekonomik të kredisë bankare. Diferenca midis çmimit të shitjes dhe të riblerjes trajtohet si shpenzim interesi dhe maturohet përgjatë jetës së marrëveshjes duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Ndërkohë letrat me vlerë të blera përmes marrëveshjeve për rishitje në një datë të ardhshme të specifikuar, marrëveshjet e anasjella të riblerjes ("Marrëveshje të anasjella të riblerjes"), regjistrohen si detyrime ndaj bankave të tjera ose hua dhe paradhënie për klientë, sipas rastit. Pagesat përkatëse të kryera, duke përfshirë interesin e përlllogarit, njihen në pasqyrën e pozicionit financiar si detyrime ndaj bankave. Diferenca midis çmimit të blerjes dhe atij të rishitjes trajtohet si e ardhur nga interesi dhe maturohet përgjatë jetës së marrëveshjes duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

6.9 Qiraja

Banka vlerëson fillimet e kontratës nëse një kontratë është, ose përmban, një qira. Që do të thotë, nëse kontrata përmban të drejtën e kontrollit të përdorimit të një aktivit të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të përfitimeve.

i. Banka si Qiramarrës

Banka aplikon një qasje të vetme njohjeje dhe matjeje për të gjitha qiradhëniet, përveç qirave afatshkurtra dhe qirave të aktiveve me vlerë të ulët. Banka njih detyrimet e qirasë për të bërë pagesa qiraje dhe aktive me të drejtë përdorimi që përfaqësojnë të drejtën e përdorimit të aktiveve bazë.

Aktivitet me të drejtë përdorimi

Banka njih aktivitet me të drejtë përdorimi në datën e fillimit të qirasë (d.m.th. data kur aktiviteti bazë është disponueshëm për përdorim). Aktivitet me të drejtë përdorimi maten me koston, minus çdo humbje të akumuluar dhe humbje nga zhvlerësimi, dhe rregullohen për çdo rivlerësim të detyrimeve të qirasë. Kostoja e aktiveve me të drejtë përdorimi përfshin shumën e detyrimeve të njohura të qirasë, koston fillestare direkte të marra mbi vete, dhe pagesat e qirasë të bëra në ose para datës së fillimit, minus çdo stimulim qiraje të marrë. Aktivitet me të drejtë përdorimi zhvlerësohen në bazë lineare gjatë afatit të qirasë.

Aktivitet me të drejtë përdorimi paraqiten në Shënimin 25 për aktive afatgjata materiale dhe aktivitet me të drejtë përdorimi dhe i nënshtrohen zhvlerësimit në përputhje me politikën e Bankës, siç përshkruhet në Shënimin 6.12 zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

6. Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

6.9 Qira (vazhdim)

i. Banka si Qiramarrës (vazhdim)

Detyrimet e qirasë

Në datën e fillimit të qirasë, Banka njeh detyrimet e qirasë të matura me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që do të bëhen gjatë afatit të qirasë. Pagesat e qirasë përfshijnë pagesa fikse, minus çdo stimulim qiraje të arkëtueshme. Pagesat e qirasë përfshijnë gjithashtu çmimin e periudhës të një opsioni blerjeje që do të ushtrohet në mënyrë të arsyeshme nga Banka dhe pagesa të penaltiteteve për ndërprerjen e qirasë, nëse afati i qirasë pasqyron ushtrimin e opsionit të ndërprerjes.

ii. Banka si Qiradhënës

Qiradhëniet në të cilat Banka nuk transferon në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e rastësishme nga një aktiv klasifikohen si qira operative. Të ardhurat që gjenerohen nga qiraja kontabilizohen mbi bazën lineare mbi kushtet e qirasë dhe përfshihen në të ardhura në pasqyrën e fitimit ose humbjes për shkak të natyrës së saj operative. Kostot e drejtpërdrejta fillestare të bëra në negociimin dhe rregullimin e një qiraje operative i shtohen vlerës kontabël të aktivit të marrë me qira dhe njihen gjatë afatit të qirasë mbi të njëjtën bazë si të ardhura nga qiraja. Qiratë e kushtëzuara njihen si të ardhura në periudhën në të cilën janë fituar.

6.10 Aktivet afatgjata materiale dhe aktive me të drejtë përdorimi

Pronat dhe pajisjet paraqiten me kosto duke përjashtuar kostot e shërbimit të përditshëm, minus zhvlerësimin e akumuluar dhe zhvlerësimin e akumuluar në vlerë. Aktivet me të drejtë përdorimi paraqiten së bashku me pronën dhe pajisjet në pasqyrën e pozicionit financiar - referojuni politikës së kontabilitetit në Shënimin 6.9. ku aktivet me të drejtë përdorimi zhvlerësohen mbi bazë lineare gjatë afatit të qirasë.

Zhvlerësimi llogaritet duke përdorur metodën lineare për të regjistruar koston e pronës dhe pajisjeve me vlerat e tyre të mbetura përgjatë jetëve të tyre të vlerësuara të dobishme. Toka nuk është zhvlerësuar. Jetët e dobishme të vlerësuara janë si më poshtë:

- Ndërtesat e veta: deri në 20 vjet
- Mobilie dhe pajisje të tjera: 5 vjet
- Automjete: 5 vjet
- Njësia kompjuterike: 4 vjet
- Përmirësime të qiradhënies: shkurtësia e jetës së dobishme dhe afatit të qirasë.

Vlera e mbetur e aseteve dhe jeta e dobishme rishikohen dhe rregullohen nëse është e përshtatshme, në çdo datë raportimi.

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur bëhet nxjerrja jashtë përdorimi e aktivit ose kur nuk priten përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi ose nxjerrja e tij jashtë përdorimi. Çdo fitim ose humbje që vjen nga çregjistrimi i aktivit (llogaritur si diferenca midis të ardhurave neto të nxjerrjes jashtë përdorimit dhe vlerës kontabël të aktivit) njihet në "Të ardhura të tjera operative" ose "Shpenzime të tjera operative" në fitimin ose humbjen e vitit kur aktivi çregjistrohet.

6.11 Aktive jo-materiale

Aktivitet jo-materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje nga zhvlerësimi. Amortizimi llogaritet mbi bazën e metodës lineare përgjatë jetës së dobishme të pritshme të aktivit. Jeta e dobishme e vlerësuar për periudhat aktuale dhe krahasuese është si më poshtë:

- | | |
|---|----------------|
| | në vite |
| • Programe kompjuterike dhe aplikacione | 4-10 |

6.12 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlerat kontabël e aktiveve jo-financiare të Bankës, përveç aktiveve të tatimit të shtyrë dhe inventarëve, rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues të zhvlerësimit. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose njësia e tij gjeneruese e mjeteve monetare tejkalon shumën e rikuperueshme. Një njësi gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i aktiveve të identifikueshme që gjenerojnë flukset monetare që janë kryesisht të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në lidhje me njësitë gjeneruese të mjeteve monetare ndahen së pari për të zvogëluar vlerën kontabël të çdo emri të mirë të caktuar për njësitë dhe më pas për të zvogëluar vlerën kontabël të aktiveve të tjera në njësi (grupi i njësive) mbi një bazë proporcionale.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

6. Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

6.12 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare (vazhdim)

Shuma e rikuperueshme e një aktivi ose njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është vlera më e madhe e saj në përdorim dhe vlera e drejtë e tij minus koston e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e parashikuara të mjeteve monetare zbriten në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë zbritje para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

6.13 Kontratat e garancisë financiare

Kontratat e garancisë financiare kërkojnë që emetuesi të kryejë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për humbje që ai ndesh si pasojë e mosshlyerjes të një huamarrësi të caktuar në datën e detyrimit, në përputhje me kushtet e instrumentit të borxhit.

Këto garanci financiare u jepen bankave, institucioneve financiare dhe organizatave të tjera për llogari të klientëve për të siguruar kredi, paradhënie dhe produkte të tjera bankare. Garancitë financiare njihen fillimisht të pasqyrave financiare me vlerë të drejtë në datën kur garancia jepet. Pas njohjes fillestare, detyrimet e bankës në sajë të këtyre garancive maten me vlerën më të madhe midis matjes fillestare, minus amortizimin e llogaritur për të njohur në fitim ose humbje tarifat e fituara në mënyrë lineare përgjatë jetës së garancisë dhe vlerësimit më të mirë të shpenzimit të kërkuar për të shlyer çdo detyrim të garancisë financiare në datën e raportimit. Këto vlerësime përcaktohen në bazë të eksperiencës me transaksione të ngjashme dhe historikut të humbjeve, të mbështetur nga gjykimi i stafit drejtues. Çdo rritje në detyrim nga garancitë regjistrohet në fitim ose humbje si shpenzime të tjera operative.

Garancitë dhe angazhimet financiare për të dhënë kredi, njihen fillimisht me vlerën e drejtë, e cila evidentohet normalisht nga shuma e tarifave të marra. Kjo shumë amortizohet në mënyrë lineare përgjatë jetës së angazhimit.

6.14 Borxhi i emëtuar dhe fonde të tjera të huazuara

Borxhi i varur i emëtuar njihet fillimisht në datën e tregtimit, d.m.th., datën në të cilën Banka bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit. Banka njihet detyrimet e obligacioneve të varura kur fondet i transferohen Bankës. Pas matjes fillestare, borxhi i varur i emëtuar matet më pas me koston e amortizuar. Kostot e transaksionit njihen në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Shpenzimet e interesit llogariten me normën nominale të interesit dhe njihen në fitim ose humbje kur llogariten. Interesi i përllogaritur por i papaguar transferohet në llogarinë e të ardhurave dhe njihet si aktiv ose detyrim në llogarinë "interesi i përllogaritur".

6.15 Përfitimet e punonjësve

Banka paguan kontribute në planet e pensioneve të punonjësve të saj sipas kërkesave të legjislacionit vendas për sigurimet shoqërore. Detyrimet për pensione të Bankës, lidhen vetëm me plane me kontribut të përcaktuar. Planet me kontribut të përcaktuar, të bazuar mbi pagat, bëhen me institucionin e administruar nga Shteti (Instituti i Sigurimeve Shoqërore) përgjegjës për pagesën e pensioneve. Banka nuk ka detyrime të mëtejshme pas pagesës së kontributit. Kontributet përbëjnë kosto neto periodike për vitin në të cilin ato lindin dhe njihen si shpenzime personeli në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse.

6.16 Provizionet

Provizionet njihen kur banka ka një detyrim aktual (ligjor apo konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe ka shumë mundësi që të ekzistojë një dalje burimesh që kërkohet për të shlyer detyrimin; dhe shuma mund të matet me besueshmëri. Kur ka një numër detyrimesh të ngjashme, mundësia e daljes së burimeve për shlyerje përcaktohet duke marrë në konsideratë kategorinë e detyrimit si të ishte një. Një provizion njihet edhe nëse mundësia e daljes së burimeve në lidhje me çdo zë të përfshirë në të njëjtën kategori detyrimesh mund të jetë e vogël.

Provizionet maten me vlerën aktuale të shpenzimeve që do të kërkohen për të shlyer detyrimin duke përdorur një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut në lidhje me vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të lidhura me detyrimin. Rritja në provizion me kalimin e kohës njihet si shpenzim interesi.

6.17 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin paraqiten në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi ose të miratuar nga ana thelbësore deri në datën e raportimit. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë dhe njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse nëse nuk është njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse kur lidhet me transaksione që njihen gjithashtu, në të njëjtën ose një tjetër periudhë, në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

6. Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

6.17 Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Tatimi aktual

Aktivitet dhe detyrimet aktuale tatimore për vitin në vazhdim dhe vitet e mëparshme maten me shumën që pritet të merret apo t'u paguhet autoriteteve tatimore. Normat tatimore dhe ligjet tatimore që përdoren për të përlogaritur shumën janë ato që janë në fuqi apo konsiderohen të miratuara në parim duke filluar nga data e raportimit 2021: 15% (2020: 15%).

Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë llogaritet kundrejt diferencave të përkohshme midis bazave tatimore të aktiveve dhe detyrimeve dhe vlerave kontabël për raportim financiar në datën e raportimit. Detyrimet tatimore të shtyra njihen për të gjitha diferencat e përkohshme, përveç rasteve kur detyrimi tatimor i shtyrë rezulton nga njohja fillestare e emrit të mirë ose e një aktivi apo detyrimi në një transaksion që nuk është kombinim biznesi dhe, në kohën e transaksionit, nuk ndikon as fitimi kontabël dhe as fitimi ose humbja e tatueshme.

Aktivitet tatimore të shtyra njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të zbritshme, kreditimet tatimore të pashfrytëzuara dhe humbje tatimore të pashfrytëzuara, deri në atë masë sa është e mundshme që fitimi i tatueshëm të jetë i disponueshëm, kundrejt të cilit diferencat e përkohshme të zbritshme, kundrejt të cilave diferencat e përkohshme të zbritshme dhe kreditimet dhe humbjet tatimore të bartura mund të përdoren, do të jenë të disponueshme, përveç rasteve kur aktivi tatimor i shtyrë që lidhet me diferencat e përkohshme të zbritshme rezulton nga njohja fillestare e një aktivi apo detyrimi në një transaksion që nuk është kombinim biznesi, dhe në kohën e transaksionit, nuk ndikon fitimin kontabël apo fitim ose humbjen e tatueshme.

Vlera kontabël e aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet deri në atë masë sa nuk është më e mundur që fitimi i tatueshëm të jetë të gjithë ose një pjesë të aktivitet tatimor të shtyrë që të shfrytëzohet.

Aktivitet e panjohura e tatimeve të shtyra rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen në atë masë që është bërë e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm të lejohet rikuperimin e aktivitet tatimor të shtyrë. Aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra maten me normat e taksave që pritet të zbatohen në vitin kur aktivi është realizuar ose detyrimi është shlyer, bazuar në tarifat tatimore (dhe ligjet tatimore) që janë në fuqi ose konsiderohen si të miratuar në parim në datën e raportimit.

Aktivitet tatimore të shtyra dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen nëse ekziston një e drejtë e ligjshme që të kompensojë aktivitet tatimore aktuale kundrejt pasiveve tatimore aktuale dhe tatimet e shtyra lidhen me të njëjtën njësi ekonomike dhe të njëjtin organ tatimor. Dividendët nga aksionet e zakonshme njihen si detyrim dhe zbriten nga kapitali kur ato miratohen nga aksionarët e Bankës. Dividendët e ndërmjetëm janë zbritur nga kapitali kur deklarohen dhe nuk është më nën diskrecionin e Bankës.

Dividendët për vitin që janë miratuar pas datës së raportimit janë paraqitur si një ngjarje pas datës së raportimit.

7. Standarde të publikuara, por ende jo efektive

Në datën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e mëposhtme të reja dhe ndryshimet në standardet ekzistuese ishin në diskutim, por ende jo efektive: .

- **Ndryshimet në SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe SNK 28 Investimet në shoqëritë e lidhura dhe sipërmarrjet e përbashkëta: Shitja ose Kontributi i Aktiveve ndërmjet një investitori dhe një shoqërie ose ndërmarrje të përbashkët** - Ndryshimet nuk janë të zbatueshme për Bankën pasi ajo nuk ka një bankë mëmë dhe as nuk ka ndikim të rëndësishëm në subjektet e tjera ekonomike.
- **SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare: Klasifikimi i detyrimeve si aktuale ose jo-aktuale (Ndryshimet)** - Ndryshimet janë efektive për periudhat e raportimit vjetore që fillojnë më 1 janarit 2022 ose më pas me leje të aplikimit të mëparshëm. Megjithatë, në përgjigje të pandemisë covid-19, Bordi ka shtyrë datën efektive me një vit, d.m.th. 1 Janar 2023, për t'u siguruar shoqërive më shumë kohë për të zbatuar ndryshimet në klasifikimet që rezultojnë nga ndryshimet.
- **SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare dhe Pasqyrave të Praktikës të SNRF 2: Zbulimi i politikave kontabël (Ndryshimet):** Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janarit 2023 ose më pas me leje të aplikimit të mëparshëm. Ndryshimet sigurojnë udhëzime për zbatimin e gjyqimeve të materialitetit në zbulimin e politikave kontabël. Në veçanti, ndryshimet në SNK 1 zëvendësojnë kërkesën për zbulim të politikave "të rëndësishme" kontabël me kërkesën për zbulim të politikave "materiale" kontabël. Gjithashtu, udhëzimet dhe shembujt ilustrues i shtohen Deklaratës së Praktikës për të ndihmuar në zbatimin e koncepteve të materialitetit kur bëjmë gjyqime në lidhje me

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

zbulimet e politikave kontabël. Stafi drejtues ka vlerësuar ndryshimet dhe nuk ka ndonjë ndikim në pasqyrat financiare.

7. Standarde e publikuara, por ende jo efektive (vazhdim)

- **SNK 8 Politikat kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet: Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (Ndryshimet):** Ndryshimet konsiderohen efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më 1 Janarit 2023 ose më pas me leje të aplikimit të mëparshëm dhe zbatohen në ndryshimet e politikave kontabël dhe ndryshimet e vlerësimeve kontabël që ndodhin në fillimit të asaj periudhe ose më pas. Ndryshimet përfshijnë një përkufizim të ri të vlerësimeve kontabël, të përcaktuar si shuma monetare në pasqyrat financiare që janë subjekt i pasigurive në matje. Gjithashtu, ndryshimet qartësojnë se cilat janë ndryshime në vlerën kontabël dhe se si ato ndryshojnë përmes ndryshimeve në politikat kontabël dhe korrigjimeve të gabimeve. Stafi drejtues ka vlerësuar ndryshimet dhe nuk ka ndonjë ndikim në pasqyrat financiare.
- **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit; SNK 16 Aktivët afatgjatë materiale; SNK 37 Provizione, Detyrime e Kushtëzuara dhe Aktivët e Kushtëzuara si dhe Përmirësime Vjetore 2018-2020 (Ndryshimet) -** Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janarit 2022 ose më pas me leje për aplikim të mëparshëm. BSNK lëshoi ndryshimet me veprim të ngushtë në Standardet e SNRF si më poshtë:
 - **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit (Ndryshimet)** përditëson një referencë në SNRF 3 në Kornizën Konceptuale për Raportimet Financiare pa ndryshuar kërkesat e kontabilitetit për kombinimet e biznesit.
 - **SNK 16 Aktivët afatgjatë materiale (Ndryshimet)** ndalon Bankën të zbresë nga kostot e aktiveve afatgjatë materiale të marra nga shitja e artikujve të prodhuar ndërsa Banka po përgatit aktivet për përdorimin që ka menduar. Nga ana tjetër, një Bankë do të njohë të ardhurat e shitjeve të tilla dhe kostot në lidhje me fitimin ose humbjen.
 - **SNK 37 Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivët e Kushtëzuara (Ndryshimet)** qartësojnë se cilat kosto përfshin një Bankë në përcaktimin e kostove për përmbushjen e një kontrate për qëllimin e vlerësimit nëse një kontratë është e vështirë.
 - **Përmirësimet Vjetore 2018-2020** bëjnë ndryshime të vogla në SNRF 1 Miratimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare në Raportimet Financiare, SNRF 9 Instrumentet Financiare, SNK 41 Bujqësia dhe Shembuj ilustrues që shoqërojnë SNRF 16 Qiratë.
- **SNRF 16 Qiratë - Covid 19 Koncesionet e Qirase përtej datës 30 qershor 2021 (Ndryshimi)** Ndryshimi zbatohet për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 Prill 2021, me aplikim të mëhershëm të lejuar, duke përfshirë në pasqyrat financiare të paautorizuara ende për publikim në datën e lëshimit të ndryshimit. Në mars 2021, Bordi ndryshoi kushtet e dobisë praktike në SNRF 16 që ofron lehtësim për qiramarrësit nga zbatimi i udhëzimit të SNRF 16 mbi modifikimet e qirasë për koncesionet e qirasë që lindin si pasojë e drejtpërdrejtë e pandemisë Covid-19. Pas ndryshimit, leverdi praktik tani zbatohet për koncesionet e qirasë, për të cilat çdo reduktim në pagesat e qirasë prek vetëm pagesat që fillimisht duhet të paguhet më 30 qershor 2022 ose para datës 30 qershor 2022, me kusht që të plotësohen kushtet e tjera për aplikimin e leasingut praktik. Drejtimi ka vlerësuar se ndryshimi nuk do të ketë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.
- **SNK 12 Tatimet mbi të ardhurat: Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm (Ndryshimet)**

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023 me aplikim të mëhershëm të lejuar. Në maj 2021, Bordi nxori ndryshime në SNK 12, të cilat ngushtojnë objektin e përjashtimit të njohjes fillestare sipas SNK 12 dhe specifikojnë se si kompanitë duhet të llogarisin për tatimin e shtyrë për transaksione të tilla si qiratë dhe detyrimet e ndërprerjeve. Sipas ndryshimeve, përjashtimi i njohjes fillestare nuk zbatohet për transaksionet që, në njohjen fillestare, sjellin diferenca të përkohshme të barabarta të tatueshme dhe të zbritshme. Ai zbatohet vetëm nëse njohja e një aktivi me qira dhe pasivi i qirasë sjellin diferenca të përkohshme të tatueshme dhe të zbritshme që nuk janë të barabarta. Drejtimi ka vlerësuar se ndryshimi nuk do të ketë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.

Banka ka zgjedhur të mos miratojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datës së hyrjes në fuqi. Banka parashikon që miratimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës në periudhën e aplikimit fillestar.

8. Gjykime, vlerësime dhe supozime të rëndësishme të kontabël

Tabela më sipër paraqet skenarin më negativ të ekspozimit të rrezikut të kredisë në Bank në 31 dhjetor 2021 dhe 2020, pa marrë parasysh asnjë garanci të mbajtur si kolateral apo siguruesit e tjerë të kredisë. Për aktivet në bilanc, ekspozimet e përcaktuara më lart bazohen në vlerat neto kontabël siç raportohet në bilanc.

Drejtimi është i konfident tek aftësia e tij që të vazhdojë të kontrollojë dhe mbështesë ekspozimin minimal ndaj rrezikut kreditor të Bankës që rezulton nga portofoli i saj i huave dhe paradhënieve dhe letrave me vlerë të borxhit, bazuar në sa vijon:

- 95.6% e portofolit të huave dhe paradhënieve kategorizohen në dy shkallët më të larta të sistemit të vlerësimit të brendshëm (2020: 92.2 %)
- Huatë për NVM-të, që përfaqësojnë grupin më të madh në portofol, janë të mbrojtura me kolateral;
- 86.11% e portofolit të huave dhe paradhënieve konsiderohen pa ditëvonesa dhe të pazhvlërsuara (2020: 81.20 %); dhe
- Banka ka filluar zbatimin e një procesi më të rreptë të përzgjedhjes për dhënien e huave dhe paradhënieve.

Ndryshimet dhe lëvizjet midis kategorive të rrezikut janë detajuar më tej në Shënimin 20.

Huatë dhe paradhëniet përmbledhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021		31 dhjetor 2020	
	Hua dhe paradhënie për klientët	Depozitat dhe llogari me Bankat	Hua dhe paradhënie për klientët	Depozitat dhe llogari me Bankat
Performuese	40,314,737	3,400,124	32,516,679	5,817,375
Me ditë vonesa, por jo të zhvlërsuara	4,547,458	-	4,818,847	-
Të zhvlërsuara individualisht	1,955,150	-	2,709,630	-
Bruto	46,817,345	3,400,124	40,045,156	5,817,375
Minus: fondi për zhvlërim	(2,008,629)	(95)	(2,054,024)	(197)
Vlera kontabël	44,808,715	3,400,028	37,991,132	5,817,178

Informacion i mëtejshëm mbi fondin e zhvlërsimit të detyrimeve nga bankat dhe huatë dhe paradhëniet për klientët paraqitet në Shënimet 19 dhe 20.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***9. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****9.1. Rreziku i kredisë (vazhdim)****9.1.6. Hua dhe paradhënie**a) *Hua dhe paradhënie pa ditëvonesa dhe jo të zhvlerësuara*

Cilësia e kredisë së portofolit të huave dhe paradhënieve të cilat janë pa ditëvonesa dhe jo të zhvlerësuara (klasifikuar si standarte) më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 mund të vlerësohet duke iu referuar sistemit të brendshëm të vlerësimit të adoptuar nga Banka, si më poshtë:

	31 dhjetor, 2021							
	<u>Individë (klientë me pakicë)</u>			Klientë të mëdhenj të korporatave	<u>Korporata</u>		Huatë dhe paradhëniet totale për klientët	Depozita dhe llogarot me Bankat
	Konsumatori/ Overdraft	Kartat e kreditit	Hipotekat		Sipërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM)			
Vlera kontabël, bruto	2,994,698	149,159	9,126,853	23,237,606	4,806,421	40,314,737	3,400,124	
Minus: fondin e zhvlerësimit	(75,250)	(5,222)	(62,190)	(232,074)	(46,890)	(421,626)	(95)	
Vlera kontabël, neto	2,919,448	143,937	9,064,663	23,005,533	4,759,531	39,893,111	3,400,028	

	31 dhjetor 2020							
	<u>Individë (klientë me pakicë)</u>			Klientë të mëdhenj të korporatave	<u>Korporata</u>		Huatë dhe paradhëniet totale për klientët	Depozita dhe llogarot me Bankat
	Konsumatori/ Overdraft	Kartat e kreditit	Hipotekat		Sipërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM)			
Vlera kontabël, bruto	2,544,122	114,315	7,184,643	2,246,517	20,427,081	32,516,679	5,817,375	
Minus: fondin e zhvlerësimit	(64,548)	(7,480)	(42,692)	(23,375)	(345,453)	(483,547)	(197)	
Vlera kontabël, neto	2,479,575	106,835	7,141,951	2,223,143	20,081,628	32,033,131	5,817,178	

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***9. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****9.1. Rreziku i kredisë (vazhdim)****9.1.6. Hua dhe paradhënie (vazhdim)**

Hua dhe paradhënie në klasat nën-standarde dhe të dyshimta u konsideruan se nuk ishin të zhvlerësuara pasi u morën parasysh rikuperueshmërinë nga kolaterali për hipotekat e klientëve me pakicë dhe huatë konsumatore.

b) *Hua dhe paradhënie të vonuara, por jo të zhvlerësuara*

Shuma e bruto e huave dhe paradhënies që vonohen, por nuk janë zhvlerësuar:

	31 dhjetor 2021	<u>Korporatë dhe SME</u> 31 dhjetor 2020
Ditëvonesa nga 1 deri në 30 ditë	667,998	949,242
Ditëvonesa nga 31-90 ditë	1,093,068	1,130,596
Ditëvonesa > 90 ditë	117,582	192,887
Totali	1,878,648	2,272,726
Vlera e drejtë e kolateralit	1,863,961	2,113,653
Totali i Huave dhe paradhënies me ditëvonesa por të pazhvlerësuara më 31 dhjetor	4,547,458	4,818,847

	31 dhjetor 2021 <u>Individë (klientë me pakicë)</u>			
	Konsumatori/ Overdraft	Hipoteka	Kartat Viza	Totali
Ditëvonesa nga 1 deri në 30 ditë	409,679	1,678,143	15,350	2,103,171
Ditëvonesa nga 31-90 ditë	109,774	355,441	3,573	468,788
Ditëvonesa > 90 ditë	-	96,850	-	96,850
Totali	519,453	2,130,434	18,922	2,668,810
Vlera e drejtë e kolateralit	238,398	1,863,183	-	2,101,581

	31 dhjetor 2020 <u>Individë (klientë me pakicë)</u>			
	Konsumatori/ Overdraft	Hipotekat	Kartat Viza	Totali
Ditëvonesa nga 1 deri në 30 ditë	377,436	1,337,012	36,642	1,751,090
Ditëvonesa nga 31-90 ditë	188,537	485,757	3,710	678,003
Ditëvonesa > 90 ditë	-	117,029	-	117,029
Totali	565,973	1,939,797	40,351	2,546,122
Vlera e drejtë e kolateralit	325,251	1,778,388	-	2,103,639

Nuk ka hua dhe paradhënie ndaj bankave më 31 dhjetor 2021 dhe 2020, të cilat janë me vonesë por nuk janë zhvlerësuar.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***9. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****9.1. Rreziku i kredisë (vazhdim)****9.1.6. Hua dhe paradhënie (vazhdim)***c) Huatë dhe paradhëniet e zhvlerësuara*

Ndarja e shumës bruto të huave dhe paradhënieve me vlerë të veçantë zhvlerësimi sipas klasës, së bashku me vlerën e drejtë të kolateralit të lidhur, të mbajtur nga Banka si siguri, janë si më poshtë:

	Konsumatori dhe Kartat		Korporata dhe SME	Totali
	Visa	Hipoteka		
31 dhjetor 2021				
Hua të zhvlerësuara individualisht	28	-	1,233,822	1,233,850
Vlera e drejtë e kolateralit	-	-	1,206,032	1,206,032
31 dhjetor 2020				
Hua të zhvlerësuara individualisht	626	-	1,783,619	1,784,245
Vlera e drejtë e kolateralit	-	-	1,465,594	1,465,594

Ndarja e shumës bruto të kredive dhe paradhënieve me zhvlerësim kolektiv sipas klasës, së bashku me vlerën e drejtë të kolateralit të lidhur, të mbajtur nga Banka si siguri, janë si më poshtë:

	Konsumatori dhe Kartat		Korporata dhe SME	Totali
	Visa	Hipoteka		
31 dhjetor 2021				
Hua të zhvlerësuara kolektivisht	270,076	220,116	231,108	721,300
Vlera e drejtë e kolateralit	193,262	171,937	127,067	492,266
31 dhjetor 2020				
Hua të zhvlerësuara kolektivisht	190,269	296,453	438,663	925,385
Vlera e drejtë e kolateralit	81,004	227,359	366,778	675,140

Vlera e drejtë e shpalosur e kolateralit përcaktohet nga vlerësuesit lokalë të certifikuar dhe përfaqëson vlerën e realizuar nga pronarët e ligjshëm të pasurive. Drejtimi i konsideron kreditë e mbuluara nga kolaterale për kreditë e korporatave si të zhvlerësuara sepse përvoja tregon se një pjesë e konsiderueshme e kolateralit në kreditë e korporatave nuk mund të zbatohet për shkak të vështirësive administrative dhe ligjore siç është zvogëlimi i vlerës së kolateralit në ankandet e administruara nga zyra përmbartimore, koha e domosdoshme që kolaterale të zbatohen. Provizionet e zhvlerësimit pasqyrojnë mundësinë që Drejtimi nuk do të jetë në gjendje të zbatojë të drejtat e tij dhe të rivendosë kolateralin në kreditë e dështuara. Pavarësisht vështirësive në zbatimin e rimarrjes së kolateralit, Drejtimi i Bankës do të ndjekë me vigjilencë borxhet e mbetura me të gjitha mjetet e mundshme në dispozicion të tyre.

Më 31 dhjetor 2021 dhe 2020, Banka nuk ka detyrime ndaj bankave të zhvlerësuara individualisht.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***9. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****9.1. Rreziku i kredise (vazhdim)****9.1.6. Hua dhe paradhenie (vazhdim)***c) Huate dhe paradhëniet e zhvlerësuara (vazhdim)**i) Analiza e kredive të fazës 2 që pasqyron kriteret për përfshirje në fazën 2*

Një analizë e bilanceve të fazës 2 në datën e raportimit që pasqyron arsyet e përfshirjes në fazën 2 sipas klasës së huave dhe paradhënieve për klientët (vlera kontabël bruto dhe HPK korresponduese) është paraqitur më poshtë. Për qëllimet e kësaj analize, ku bilancet plotësojnë më shumë se një kriter për përcaktimin e një rritjeje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë, vlera kontabël bruto përkatëse dhe HPK janë caktuar sipas rendit të kategorive të paraqitura, për shembull, llogaritë me përkeqësim të probabilitetit të deshtimisht (PD) mund të aktivizojnë ndalesa, por raportohen vetëm nën "Lëvizja e PD". Treguesit e rritjeve të ndjeshme të rrezikut të kredisë (SICR) shpjegohen në shënimin 6.5. ii)

31 dhjetor 2021	Korporat		SME		Konsumatore		Hipotekore		Totali	
	Vlera kontabël, bruto	HPK	Vlera kontabël, bruto	HPK	Vlera kontabël, bruto	HPK	Vlera kontabël, bruto	HPK	Vlera kontabël, bruto	HPK
Ditëvonesa < 30 ditë	1,255,512	108,928	386,299	21,189	86,750	21,206	159,253	14,840	1,887,813	166,163
- Lëvizja e PD	221,916	2,467	127,053	2,944	18,547	2,179	51,781	3,125	419,298	10,716
- Mbështetje e ofruar për modifikimet	387,868	90,168	104,766	10,953	-	-	-	-	492,634	101,121
- Arsye të tjera kualitative	645,728	16,293	154,480	7,292	68,202	19,027	107,472	11,715	975,882	54,327
Ditëvonesa > 30 ditë	1,201	8	18,059	360	92,973	27,118	242,785	28,441	355,018	55,928
Totali	1,256,713	108,937	404,358	21,549	179,723	48,324	402,038	43,281	2,242,832	222,091

31 dhjetor 2020	Korporat		SME		Konsumatore		Hipotekore		Totali	
	Vlera kontabël, bruto	HPK	Vlera kontabël, bruto	HPK	Vlera kontabël, bruto	HPK	Vlera kontabël, bruto	HPK	Vlera kontabël, bruto	HPK
Ditëvonesa < 30 ditë	1,100,923	124,419	438,151	35,156	231,403	67,646	465,033	37,288	2,235,510	264,509
- Lëvizja e PD	230,071	20,706	132,504	15,436	-	-	-	-	362,574	36,142
- Mbështetje e ofruar për modifikimet	-	-	56,820	11,003	31,659	2,400	167,167	10,803	255,646	24,206
- Arsye të tjera kualitative	870,852	103,712	248,827	8,717	199,745	65,246	297,865	26,485	1,617,289	204,160
Ditëvonesa > 30 ditë	28,772	9	20,532	365	108,892	29,637	399,706	41,200	557,902	71,211
Totali	1,129,695	124,427	458,683	35,521	340,295	97,284	864,739	78,488	2,793,412	335,719

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***9. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****9.1. Rreziku i kredise (vazhdim)****9.1.6. Hua dhe paradhenie (vazhdim)**c) *Huate dhe paradhëniet e zhvlerësuar (vazhdim)*ii) *Analiza e kredive te fazës 3*

Një analizë e huave të fazës 3 është paraqitur më poshtë. Në tabelë janë paraqitur kreditë me ditëvonesa me më pak se 90 ditë dhe kreditë me ditëvonesa me më shumë se 90 ditë sipas portofolit dhe sipas fazave, duke paraqitur kreditë e klasifikuara si faza 3 për shkak të vjetërsisë dhe ato të identifikuara në një fazë më të hershme për shkak të kritereve të tjera. Ekspozimet e fazës 3 analizohen më tej për të treguar ato që nuk janë më të zhvlerësuar, por në periudhë kurimi që i paraprin një transferimi përsëri në fazën 2. Analiza e kredive të fazës 3 është paraqitur më poshtë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020.

31 dhjetor 2021	Korporat			SME			Konsumatore			Hipotekore			Totali		
	Vlera kontabel, bruto	HPK	Mbulimi	Vlera kontabel, bruto	HPK	Mbulimi	Vlera kontabel, bruto	HPK	Mbulimi	Vlera kontabel, bruto	HPK	Mbulimi	Vlera kontabel, bruto	HPK	Mbulimi
Ditëvonesa < 90 ditë	596,203	185,176	31%	131,353	41,871	32%	80,983	34,155	42%	217,254	59,820	28%	1,025,793	321,022	31%
Ditevonesa > 90 ditë	666,375	489,697	73%	281,243	142,581	51%	234,291	175,870	75%	283,241	140,997	50%	1,465,150	949,145	65%
Totali	1,262,578	674,873	53%	412,596	184,452	45%	315,274	210,025	67%	500,495	200,817	40%	2,490,943	1,270,167	51%
-Jo më të zhvlerësuar por në periudhë kurimi	151,102	42,332	28%	43,542	26,770	62%	42,310	12,863	30%	148,844	29,862	20%	385,797	111,828	29%
-Të tjera	1,111,476	632,541	57%	369,054	157,682	43%	272,965	197,162	72%	351,651	170,955	49%	2,105,146	1,158,339	55%

31 dhjetor 2020	Korporat			SME			Konsumatore			Hipotekore			Totali		
	Vlera kontabel, bruto	HPK	Mbulimi	Vlera kontabe l, bruto	HPK	Mbulimi	Vlera kontabel, bruto	HPK	Mbulimi	Vlera kontabel, bruto	HPK	Mbulimi	Vlera kontabel, bruto	HPK	Mbulimi
Ditëvonesa < 90 ditë	1,118,381	448,823	40%	294,511	77,237	26%	62,411	23,812	38%	144,010	36,912	26%	1,619,313	586,784	36%
Ditëvonesa > 90 ditë	675,995	354,232	52%	344,969	131,933	38%	143,889	99,082	69%	359,364	110,350	31%	1,524,216	695,597	46%
Totali	1,794,376	803,055	45%	639,480	209,170	33%	206,300	122,894	60%	503,373	147,262	29%	3,143,529	1,282,381	41%
-Jo më të zhvlerësuar por në periudhë kurimi	151,102	42,332	28%	43,542	26,770	61%	42,310	12,863	30%	148,844	29,862	20%	385,797	111,828	29%
-Te tjera	1,643,274	760,723	46%	595,938	182,400	31%	163,990	110,031	67%	354,529	117,399	33%	2,757,732	1,170,554	42%

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***9. Administrim i rrezikut financiar (vazhdim)****9.1. Rreziku i kredisë (vazhdim)****9.1.6. Hua dhe paradhënie (vazhdim)**c) *Huate dhe paradhaniet e zhvleresuara (vazhdim)*iii) *Analiza e ndjeshmërishe duke konsideruar Covid-19*

Vlerësimi dhe matja e HPK është veçanërisht komplekse dhe shumë e ndjeshme në të dhëna gjatë kohërave me pasiguri dhe luhatshmëri të lartë, të cilat kërkojnë veçanërisht vlerësim të kujdesshëm të skenarëve duke shmangur ekstremet tepër optimiste dhe pesimiste, por edhe që kërkojnë ushtrimin e gjykimit, në lidhje me parashikimet makroekonomike që përdoren për vlerësimin e FLI. Kjo e fundit merr rëndësi në rrethanat e pasigurisë së lartë të pritshmërive të zhvillimeve makroekonomike gjatë vitit në vijim dhe si rrjedhojë e luhatshmërisë së lartë të këtyre parametrave.

Në vlerësimin e FLI-së, banka ka përdorur një skenar të vetëm qendror të ekonomisë, i cili përfshin zhvillimet ekonomike tashmë të materializuara të vitit 2021 dhe pritshmëritë për vitin 2022, duke llogaritur mesatarisht zhvillimin e dy viteve. Modelimi dhe zhvillimi i marrëdhënieve statistikore midis probabilitetit të dështimit dhe zhvillimeve makroekonomike ka paraqitur sfida të rëndësishme, si rezultat i efekteve neutralizuese të masave të marra nga qeveria në mbështetje të klientëve me pakicë dhe bizneseve, si dhe aplikimit të moratoriumeve. Si e tillë, ajo ka kërkuar zbatimin e gjykimit të ekspertëve në nxjerrjen e konkluzioneve mbi një FLI të mundshme të besueshme. FLI i shfrytëzuar konsideron një rikthim të mundshëm në normalitet deri në mesin e vitit 2021, prandaj Banka e kupton se, një pandemi e zgjatur dhe masat e lidhura me to mund të ndikojnë negativisht në vlerësimet mbi probabilitetin e dështimit dhe si rezultat në HPK të vlerësuar.

Ashtu siç pritej dhe konsiderohej në përputhje me fondet rezervë, cilësia e portofolit të kredisë përfituese nga moratoriumi për shkak të pandemisë, matur nga raporti i kredive me probleme ndaj portofolit specifik, ka ardhur duke u përkeqësuar gjatë vitit 2021. Konkretisht në përfundim të masave të ndërmarra nga qeveria shqiptare dhe Banka Qendrore si edhe për shkak të tkurrjes së këtij portofoli specifik (21 dhjetor: NPLR e portofolit të lidhur me COVID prej 12.3%).

Balancat e portofolit të trajtuar me COVID mbi 90 ditë me vonesë, në fund të vitit 2021, janë afërsisht 2.8 herë më të larta se këto balanca deri në fund të vitit 2020. Megjithatë, pjesa më e madhe e kësaj rritjeje lidhet me klientët tashmë të klasifikuar me NPL deri në fund të vitit 2020, ndërkohë që kjo balance përfaqëson ende vetëm 9% të këtij portofoli dhe pjesa më e madhe e tij vazhdon të shfaqë vonesa jo materiale, jo me shume se 30 ditë vonese. Një vështrim në peshën e këtij portofoli pa vonesa deri në fund të vitit 2021, tregon se ky grup kredish përfaqëson 84% të portofolit të trajtuar me COVID kundrejt 86% në fund të vitit 2020. Kjo tregon për një nivel të mirë të stabilitetit kundrejt pritshmërive dhe duke pasur parasysh zhvillimet makroekonomike të vitit të fillimit të pandemisë.

Për më tepër, pavaresisht përkeqësimit të NPLR-së në fund të dhjetorit 2021 për tre segmentet kryesore kundrejt fundit të dhjetorit 2020, të dhënat tregojnë se ky përkeqësim lidhet me uljen e balancave për këtë portofol specifik për bizneset dhe një kombinim ndërmjet uljes së këtyre balancave dhe rritjes së kredive me probleme për segmentin e individeve. Konkretisht, portofoli i trajtuar me COVID, i cili në fund të vitit 2020 kishte një peshë afërsisht 1/3 e portofolit të biznesit dhe 1/6 e portofolit të individeve, ka deri në fund të vitit 2021 një kontribut më të ulët në nivel ¼ të portofolit të biznesit dhe 1/10 e portofolit të individeve. Ai është ulur gjatë vitit me 15% kundrejt balances të tij në fund të vitit 2020.

Korporata Ditëvonesa	31 dhjetor 2021			31 dhjetor 2020		
	TOTALI	COVID	JO- COVID	TOTALI	COVID	JO-COVID
deri në 30 ditë	97%	91%	99%	96%	99%	95%
31-90 ditë	0%	0%	0%	1%	1%	0%
> 90 ditë	3%	9%	1%	3%	0%	5%
Totali	100%	100%	100%	100%	100%	100%
SME Ditëvonesa	31 dhjetor 2021			31 dhjetor 2020		
	TOTALI	COVID	JO-COVID	TOTALI	COVID	JO-COVID
deri në 30 ditë	94%	89%	96%	92%	93%	91%
31-90 ditë	1%	1%	1%	1%	1%	1%
> 90 ditë	5%	10%	4%	7%	6%	7%
Totali	100%	100%	100%	100%	100%	100%

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***9. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****9.1. Rreziku i kredisë (vazhdim)****9.1.6. Hua dhe paradhënie (vazhdim)**c) *Huate dhe paradhëniet e zhvleresuara (vazhdim)*iii) *Analiza e ndjeshmërisë duke konsideruar Covid-19 (vazhdim)*

RETAIL Ditëvonesa	31 dhjetor 2021			31 dhjetor 2020		
	TOTALI	COVID	JO-COVID	TOTALI	COVID	JO-COVID
deri në 30 ditë	94%	84%	95%	91%	79%	93%
31-90 ditë	3%	11%	2%	5%	15%	3%
> 90 ditë	3%	5%	3%	4%	5%	4%
Totali	100%	100%	100%	100%	100%	100%
TOTALI Ditëvonesa	31 dhjetor 2021			31 dhjetor 2020		
	TOTALI	COVID	JO-COVID	TOTALI	COVID	JO-COVID
deri në 30 ditë	96%	90%	97%	94%	94%	94%
31-90 ditë	1%	2%	1%	2%	4%	2%
> 90 ditë	3%	8%	2%	4%	2%	5%
Totali	100%	100%	100%	100%	100%	100%

Banka ka përzgjedhur me kujdes FLI-të të cilat përfaqësojnë një skenar më konservator kundrejt pritshmërive bazë për zhvillimet e portofolit gjatë vitit 2022, duke marrë parasysh edhe pasiguritë për vitin në vijim lidhur me zhvillimet ndërkombëtare dhe ndikimin e tyre në ekonominë vendase.

Këto FLI përdoren më tej në procesin e krijimit të fondeve rezervë, në pritje të përkeqësimeve të mundshme përtej asaj që pritej në skenarin bazë. Konkretisht, në skenarin bazë, Banka ka parashikuar një rritje të portofolit të kredive me probleme me rreth 11% gjatë vitit 2022, ndërkohë që ka krijuar rezerva duke konsideruar një skenar më konservator.

Këto FLI të përdorura parashikojnë një rritje të mundshme të balanceve të kredive me probleme deri në 5 herë më shumë se pritshmëritë sipas skenarit bazë ose përfaqësojnë një dyfishim të balanceve të kredive me probleme të portofolit të lidhur me COVID. Megjithatë portofoli i trajtuar me Covid është 1/5 e portofolit të përgjithshëm të kredive, ai përfaqëson në fakt më shumë se gjysmën e NPL-ve të tij, prandaj pritet që ai të jetë nën-portofoli i parë që do të ketë nën performancë ose deshtim.

PIT tremujore PD	T1 '21	T2 '21	T3 '21	T4 '21	Mesatare PIT PD 2021	Mesatare PIT PD 2020	Mesatare PIT PD e stresuar 2022	FLI* e stresuar
Korporata	4.9%	2.9%	3.1%	3.1%	3.5%	5.4%	3.70%	11.0%
Retail	4.3%	4.2%	3.7%	3.7%	4.0%	3.9%	4.70%	19.0%

* FLI e stresuarkonsiderohet si FLI përfundimtar për vitin 2022 sipas një skenari të unifikuar

Vështrim i përgjithshëm i kredive të modifikuara dhe të paracaktuara

Banka mund të lidhë një marrëveshje për modifikimet me një huamarrës që përballet ose pritet të përballet me vështirësi financiare për të lehtësuar detyrimin kontraktual për një periudhë kohore. Një qasje rast pas rasti zbatohet për të gjithë klientët duke marrë parasysh faktet dhe rrethanat specifike të klientit. Opsionet tipike të ripagimit të ofruara përfshijnë shpërndarjen mbi afatin e mbetur, një pagesë të njëhershme ose një zgjatje të afatit. Modifikimet varen nga gjendja ekonomike e klientit dhe nëse ndodh një modifikim, vlerësohet nevoja për një tarifë zhvlerësimi dhe nëse është e nevojshme, kredia regjistrohët si e zhvlerësuar.

Banka përdor përkufizimin e Autoritetit të Bankës Evropiane (EBA-së) për modifikimet dhe kreditë me probleme.

Një ekspozim i modifikuar mund të konsiderohet se performon nga data kur masat e modifikuara janë zgjatuar nëse plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

- zgjatja e afatit nuk ka bërë që ekspozimi të klasifikohet si jo performues (prandaj nuk evidentohet rrezik për mos shlyerje);
- ekspozimi nuk ishte në statusin jo-performues në datën e zgjatjes së masave të modifikuara;
- 1 vit nga mospërfomimi dhe kredia nuk është me vonesë më të madhe se 30 ditë.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***9. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****9.1. Rreziku i kredisë (vazhdim)****9.1.6. Hua dhe paradhënie (vazhdim)***c) Huate dhe paradhëniet e zhvlerësuara (vazhdim)**iii) Analiza e ndjeshmërisë duke konsideruar Covid19 (vazhdim)**Vështrim i përgjithshëm i kredive të modifikuara dhe të paracaktuara (vazhdim)*

Nëse nuk ka prova për të kundërtën, ekspozimet e modifikuara që plotësojnë ndonjë nga kriteret e mëposhtme duhet të klasifikohen si me probleme në çdo rast:

- Kreditë me probleme në momentin e modifikimit ose kreditë që do të klasifikoheshin me probleme në mungesë të masave të mësipërme.
- Kreditë e reja që shërbejnë për shlyerjen e ekspozimeve me probleme (në kohë afër masave të modifikuara).
- Ndryshimet e klauzolave të kontratës që parashikojnë fshirjen e borxhit.
- Modifikimet e klauzolave të kontratës që parashikojnë shlyerje nëpërmjet realizimit të kolateralit ose transferimit në Bankë.

Gjatë vitit 2020, masat e modifikuara si pasojë e krizës së COVID-19 nuk janë konsideruar si të tilla, me udhëzimin e EBA-s dhe Bankës së Shqipërisë, sipas së cilës moratoriumet në përgjigje të Covid-19 të cilat nuk janë specifike për huamarrësin, por më tepër të adresuara për një gamë të gjerë të klasave të produkteve ose klientëve, nuk duhet të klasifikohen automatikisht si masa të modifikuara, si për SNRF 9 dhe përkufizimin e dështimit. Kjo nuk heq detyrimin e institucioneve të kreditit për të vlerësuar cilësinë e kredisë së ekspozimeve dhe për të identifikuar situatat që nuk kanë gjasa të paguajnë huamarrësit në përputhje me rrethanat.

Kushtet e ofruara sipas moratoriumit nuk çuan domosdoshmërisht në një riklasifikim të ndonjë kredie sipas përkufizimit të modifikimit, si ato modifikime performuese dhe ato jo – performuese, pasi përkufizimi i modifikimit është krijuar për t'u raportuar kur institucionet e kreditit ofrojnë masa specifike për të ndihmuar një huamarrës specifik i cili po kalon ose ka gjasa të kalojë vështirësi të përkohshme financiare me shlyerjen e detyrimeve.

Si parim i përgjithshëm, përpara dhënies së një mase të modifikuar, institucionet e kreditit duhet të kryejnë një vlerësim individual të aftësisë ripaguese të huamarrësit dhe të japin masa të modifikuara të përshtatura për rrethanat specifike të huamarrësit. Skemat e moratoriumeve legjislative dhe jo-legjislative të prezantuara në përgjigje të pandemisë COVID-19 kanë një natyrë përgjithësisht parandaluese dhe nuk janë specifike për huamarrësin, pasi ato synojnë të adresojnë rreziqet sistematike që mund të ndodhin në ekonomi në të ardhmen.

Duke qenë se aplikimi i një moratoriumi të përgjithshëm nuk u konsiderua si masë e modifikuar, po ashtu ai nuk është konsideruar si një ristrukturim në vështirësi.

Aktivitet e modifikuara me kosto të amortizuar

Në '000 Lek	Ekspozimi		HPK	
	2021	2020	2021	2020
Faza 1	-	-	-	-
Faza 2	418,331	237,140	10,716	24,783
Faza 3	1,382,760	1,189,535	647,357	436,173
Totali i kredive të modifikuara	1,801,091	1,426,675	658,072	460,956

Zhvillimi i aktiveve financiare të modifikuara me kosto të amortizuar

Në '000 Lek	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Gjendja në fillim të periudhës	1,426,675	1,455,153
Të klasifikuara si të modifikuara gjatë vitit	591,844	235,983
Të transferuara në të modifikuara gjatë vitit (përfshirë ripagimet)	(144,631)	(250,851)
Lëvizje të tjera duke përfshirë kursin e këmbimit	(72,797)	(13,610)
Gjendja në fund të periudhës	1,801,091	1,426,675

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***9. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****9.2. Rreziku i tregut**

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, si normat e interesit, çmimet e kapitalit, kurset e këmbimit dhe normat e kredisë (që nuk lidhen me ndryshimet në gjendjen kreditore të detyruesit/emetuesit) do të ndikojnë të ardhurat e bankës ose vlerën e pjesëmarrjeve të saj në instrumentet financiare. Qëllimi i menaxhimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimin ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin ndaj riskut. Çështjet e rrezikut të tregut ndiqen rregullisht nga "Komiteti i Menaxhimit të Aktiveve dhe Detyrimeve" (ALCO).

9.2.1. Rreziku i këmbimit valutor

Rreziku i monedhës është rreziku që vlera e instrumenteve financiare do të luhetet për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit valutor. Banka përpiqet ta menaxhojë këtë rrezik duke mbyllur çdo ditë pozicione të hapura në valutë dhe duke vendosur dhe monitoruar limitet e pozicioneve të hapura.

Përqendrimet e rrezikut të monedhës dhe instrumentet financiare brenda dhe jashtë bilancit janë paraqitur më poshtë:

Më 31 dhjetor 2021	EURO	USD	LEK	Monedha të tjera	Totali
Aktive					
Mjete monetare dhe llogari me BQ	4,935,602	476,804	3,348,786	47,328	8,808,519
Depozita dhe llogari me bankat	2,044,485	624,218	-	731,325	3,400,029
Hua dhe paradhëniet për klientët, neto	24,975,918	1,227,980	18,592,792	12,025	44,808,715
Aktive financiare në VDATGJ	11,474,779	-	19,332,339	-	30,807,118
Aktive financiare me KA	3,526,775	-	2,060,816	-	5,587,591
Aktive të tjera	-	-	349,208	-	349,208
Totali i aktiveve financiare	46,957,558	2,329,002	43,683,941	790,678	93,761,180
Detyrimet dhe kapitali					
Detyrime ndaj bankave	17,501	-	860,546	12,851	890,898
Detyrime ndaj klientëve	38,987,543	2,356,873	40,304,863	761,239	82,410,517
Borxhi i varur	607,176	-	-	-	607,176
Detyrime qiraje	445,673	15,935	20,673	-	482,280
Kapitali	5,917,986	-	-	-	5,917,986
Totali i detyrimeve financiare dhe kapitalit	45,975,879	2,372,807	41,186,081	774,089	90,308,857
Pozicioni neto i monedhës në bilanc	981,679	(43,805)	2,497,859	16,589	3,452,323
Zërat jashtë bilancit	4,603,475	693,534	2,653,979	-	7,950,988

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***9. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****9.2. Rreziku i tregut (vazhdim)****9.2.1. Rreziku i këmbimit valutor (vazhdim)**

Më 31 dhjetor 2020	EURO	USD	Monedha		Totali
			LEK	të tjera	
Aktive					
Mjete monetare dhe llogari me BQ	3,652,681	425,110	2,873,691	21,336	6,972,818
Depozita dhe llogari me bankat	3,588,679	1,496,284	-	732,214	5,817,178
Hua dhe paradhëniet për klientët, neto	20,191,104	837,740	16,948,722	13,566	37,991,132
Aktive financiare në VDATGJ	7,668,561	-	18,765,449	-	26,434,010
Aktive financiare me KA	3,594,101	-	-	-	3,594,101
Aktive të tjera	14,604	-	160,800	-	175,404
Totali i aktiveve financiare	38,709,730	2,759,134	38,748,662	767,116	80,984,643
Detyrimet dhe kapitali					
Detyrime ndaj bankave	25,527	-	1,821,434	13,737	1,860,698
Detyrime ndaj klientëve	31,688,824	2,772,093	36,366,569	741,828	71,569,314
Detyrime qiraje	192,826	33,066	11,219	-	237,111
Kapitali	5,917,986	-	-	-	5,917,986
Totali i detyrimeve financiare	37,825,163	2,805,159	38,199,222	755,565	79,585,109
Pozicioni neto i monedhës në bilanc	884,567	(46,025)	549,440	11,551	1,399,534
Zërat jashtë bilancit	2,769,105	123,451	2,964,732	-	5,857,288

Analiza e ndjeshmërisë së rrezikut të monedhës

Banka është kryesisht e ekspozuar ndaj euros dhe dollarit amerikan (USD). Tabela e mëposhtme detajon ndjeshmërinë e Bankës ndaj rritjes dhe rënies përkatëse të vlerës së Lekut ndaj valutave të huaja. Përqindja e përdorur është shkalla e ndjeshmërisë së përdorur gjatë raportimit të rrezikut në valutë të huaj për stafin e drejtimit të lartë dhe paraqet vlerësimin e drejtimit të Bankës për ndryshimin e arsyeshëm dhe të mundshëm të kursit të këmbimit. Analiza e ndjeshmërisë përfshin vetëm zëra monetarë të shprehur në monedhë të huaj aktive dhe rregullon përkthimin e tyre në fund të periudhës për një ndryshim përkatës në kurset e valutës së huaj. Banka ka aplikuar një rritje ose ulje prej 10% në kurset e këmbimit të valutës. Një numër pozitiv më poshtë tregon një rritje në fitim dhe kapitalin tjetër neto ku LEK-u forcohet me përqindjet përkatëse ndaj monedhës përkatëse.

	Rritje / (Rënie) në pikat bazë	31 dhjetor 21		31 dhjetor 20	
		Ndjeshmëria e fitimit ose humbjes	Ndjeshmëria e kapitalit	Ndjeshmëria e fitimit ose humbjes	Ndjeshmëria e kapitalit
EURO	+ / (-) 100	689,967	(689,967)	680,255	(680,255)
USD	+ / (-) 100	(4,381)	4,381	(4,602)	4,602
Të tjera	+ / (-) 100	1,659	(1,659)	1,155	(1,155)

9.2.2. Rreziku i normës së interesit

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare të Bankës i nënshtrohen rrezikut të luhatjeve në masën që aktivet që gjenerojnë të ardhura dhe detyrimet që mbartin të ardhura maturohen ose rivlerësohen në momente të ndryshme ose në shuma të ndryshme. Banka përpqet ta zbusë këtë rrezik duke monitoruar datat e rivlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve të saj. Për më tepër, efekti aktual do të varet nga një numër faktorësh të tjerë, duke përfshirë shkallën në të cilën ripagimet (shlyerjet) bëhen më herët ose më vonë se data e kontraktuar dhe variacionet në ndjeshmërinë e normës së interesit brenda periudhave të rivlerësimit dhe ndërmjet monedhave.

Aktivitetet e administrimit të rrezikut kanë për qëllim optimizimin e të ardhurave neto nga interesi, duke pasur parasysh nivelet e interesit të tregut në përputhje me strategjitë e biznesit të Bankës.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***9. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****9.2. Rreziku i tregut (vazhdim)****9.2.2. Rreziku i normës së interesit (vazhdim)**

Aktivitetet e administrimit të rrezikut të aktiveve-pasiveve kryhen në kontekstin e ndjeshmërisë së Bankës ndaj ndryshimeve të normës së interesit.

Në uljen e mjediseve të normave të interesit, marzhet e fituara do të ngushtohen me uljen e normave të interesit të detyrimeve me një përqindje më të ulët në krahasim me normat e interesit të aktiveve. Sidoqoftë, efekti aktual do të varet nga faktorë të ndryshëm, përfshirë stabilitetin e ekonomisë, mjedisin dhe nivelin e inflacionit.

Banka përpiqet ta zbusë këtë rrezik të normës së interesit duke monitoruar datat e rishikimit të aktiveve dhe detyrimeve të saj dhe duke vendosur afate të ripërsëritjes të produktit në mënyrë që të menaxhojë fitimin / humbjen nga ndryshimet e normave bazë të tregut. Për më tepër, Banka ka të drejta kontraktuale të rishikojë normat e interesit në pjesën më të madhe të portofolit të saj të kredisë mbi një bazë tremujore.

Tabela e mëposhtme paraqet datat e rivlerësimit të normës së interesit për aktivet dhe detyrimet e Bankës. Aktivet dhe detyrimet me normë të ndryshueshme janë raportuar në bazë të datës së ardhshme të ndryshimit të kursit. Aktivet dhe detyrimet me kurs fiks janë raportuar në bazë të datave të planifikuara të ripagimit të tyre:

Më 31 dhjetor 2021	Më pak se një muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Mbi 1 vit	Jo – mbartëse interesi	Totali
Aktive						
Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qendrore	6,937,382	-	-	-	1,871,137	8,808,519
Huatë dhe paradhëniet për bankat	3,400,028	-	-	-	-	3,400,028
Hua dhe paradhëniet për klientët, neto	4,155,469	7,443,012	32,494,606	715,628	-	44,808,715
Aktive financiare në VDATGJ	904,093	3,634,645	5,324,692	20,943,687	-	30,807,118
Aktive financiare me KA	-	-	-	5,587,591	-	5,587,591
Aktive të tjera	-	-	-	-	349,208	349,208
Totali i aktiveve financiare	15,396,973	11,077,657	37,819,298	27,246,906	2,220,346	93,761,180
Detyrimet						
Detyrime ndaj bankave	890,898	-	-	-	-	890,898
Detyrime ndaj klientëve	43,367,072	5,359,835	19,301,649	14,381,960	-	82,410,517
Borxhi i varur	-	-	-	607,176	-	607,176
Detyrime qiraje	-	-	162,436	319,844	-	482,280
Totali i detyrimeve financiare	44,257,970	5,359,835	19,464,085	15,308,980	-	84,390,870
Hendeku i ndjeshmërisë së interesit	(28,860,997)	5,717,822	18,355,213	11,937,926	2,220,346	9,370,309

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***9. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****9.2. Rreziku i tregut (vazhdim)****9.2.2. Rreziku i normës së interesit (vazhdim)**

Tabela e mëposhtme paraqet datat e rivlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve të Bankës më 31 dhjetor 2020.

Më 31 dhjetor 2020	Më pak se një muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Mbi 1 vit	Jo – mbartëse interesi	Totali
Aktive						
Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qendrore	5,768,392	-	-	-	1,204,426	6,972,818
Huatë dhe paradhëniet për bankat	5,817,178	-	-	-	-	5,817,178
Hua dhe paradhëniet për klientët, neto	3,895,699	4,963,515	27,954,562	1,177,357	-	37,991,132
Aktive financiare në VDATGJ	1,719,472	2,795,150	5,290,371	16,629,016	-	26,434,010
Aktive financiare me KA	-	-	-	3,594,101	-	3,594,101
Aktive të tjera	-	-	-	-	175,404	175,404
Totali i aktiveve financiare	17,200,741	7,758,664	33,244,933	21,400,474	1,379,831	80,984,643
Detyrimet						
Detyrime ndaj bankave	1,835,171	25,527	-	-	-	1,860,698
Detyrime ndaj klientëve	37,777,354	5,256,406	17,351,504	11,184,050	-	71,569,313
Detyrime qiraje	-	-	105,987	131,124	-	237,111
Totali i detyrimeve financiare	39,612,524	5,281,933	17,457,491	11,315,174	-	73,667,122
Hendeku i ndjeshmërisë së interesit	(22,411,784)	2,476,732	15,787,442	10,085,300	1,379,831	7,317,520

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***9. Adinistrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****9.2. Rreziku i tregut (vazhdim)****9.2.2. Rreziku i normës së interesit (vazhdim)**

Për shkak të specifikave të tregut shqiptar, një shumë e madhe e depozitave të klientëve ka një maturim më të vogël se një muaj. Megjithatë, efekti i mundshëm negativ i rritjes negative të normave interesit është ulur ndjeshëm për shkak të normave të ulëta të interesit të përcaktuara nga Banka në depozitat pa afat të klientëve.

Analiza e ndjeshmërisë së normës së interesit është përcaktuar bazuar në ekspozimin ndaj rrezikut të normës së interesit në datën e raportimit. Më 31 dhjetor 2021, nëse normat e interesit do të kishin qenë 100 pikë bazë më të larta/më të ulëta me të gjitha variablat e tjera të mbajtura konstante, fitimi para-tatimit i Bankës për periudhën dymbëdhjetë mujore që u mbyll më 31 Dhjetor 2021 do të rritej/ulej përkatësisht me rreth 70,294 mijë lekë (2020: 57,271 mijë lekë).

Analiza e ndjeshmërisë së normës së interesit sipas monedhës është paraqitur më poshtë.

	EURO	USD	Monedha të tjera	LEK	Totali
Më 31 dhjetor 2021					
Totali i aktiveve financiare që mbartin interes	46,280,600	2,157,233	743,350	42,239,110	91,420,293
Totali i detyrimeve financiare që mbartin interes	40,057,893	2,372,807	774,089	41,186,081	84,390,871
Hendeku i ndjeshmërisë së interesit	6,222,707	(215,574)	(30,740)	1,053,029	7,029,423
Ndjeshmëria nëse normat e interesit rriten me 100 pb	62,227	(2,156)	(307)	10,530	70,294
Ndjeshmëria nëse normat e interesit ulen me 100 pb	(62,227)	2,156	307	(10,530)	(70,294)
	EURO	USD	Monedha të tjera	LEK	Totali
Më 31 dhjetor 2020					
Totali i aktiveve financiare që mbartin interes	38,358,922	2,590,099	745,780	37,699,448	79,394,248
Totali i detyrimeve financiare që mbartin interes	31,907,177	2,805,159	755,565	38,199,222	73,667,123
Hendeku i ndjeshmërisë së interesit	6,451,744	(215,060)	(9,785)	(499,775)	5,727,125
Ndjeshmëria nëse normat e interesit rriten me 100 pb	64,517	(2,151)	(98)	(4,998)	57,271
Ndjeshmëria nëse normat e interesit ulen me 100 pb	(64,517)	2,151	98	4,998	(57,271)

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

9. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

9.3. Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit lind në financimin e përgjithshëm të veprimtarive të Bankës dhe në menaxhimin e pozicioneve. Ai përfshin si rrezikun e pamundësisë për të financuar aktivet me maturimin dhe normat e duhura (rrezikun e financimit), ashtu edhe rrezikun e pamundësisë për të likuiduar një aktiv me një çmim të arsyeshëm dhe në një periudhë të përshtatshme për të përmbushur detyrimet e pasivit (rreziku i likuiditetit të tregut).

Fondet janë grumbulluar duke përdorur një gamë të gjerë instrumentesh, përfshirë depozitat, detyrimet e tjera të dokumentuara me letra, dhe kapitalin aksionar. Banka bën përpjekjet e saj më të mira për të ruajtur një ekuilibër midis vazhdimësisë së financimit dhe fleksibilitetit duke përdorur detyrimet me një gamë maturimesh. Banka vazhdimisht vlerëson rrezikun e likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar ndryshimet në financimin e kërkuar për përmbushjen e qëllimeve të biznesit dhe objektivave të përcaktuara në lidhje me strategjinë e përgjithshme të Bankës, ndërkohë që rregullisht kryen testimin e stresit të rrezikut të likuiditetit e cila i paraqitet Këshillit Drejtues.

Për më tepër, Banka mban një portofol të aktiveve likuide si pjesë e strategjisë së saj të administrimit të rrezikut të likuiditetit. Nivelet e këtyre treguesve u komunikohen çdo ditë personave përgjegjës të departamenteve të Bankës, dhe komentet, si dhe vlerësimet përkatëse, përfshihen në paketën e raportimit për anëtarët e Komitetit të Përgjegjësishë së Aseteve ("ALCO").

ALCO ka përgjegjësinë të përcaktojë strategjinë për zhvillimin e aktiveve dhe detyrimeve, në varësi të të dhënave cilësore dhe sasore të organizatës dhe zhvillimeve në treg; Sigurimi i një niveli të lartë të konkurrencës dhe një organizim efektiv; Ruajtja e rreziqeve në limitet e përcaktuara; Menaxhimi i aktiveve dhe detyrimeve duke aplikuar politikat e çmimeve për produktet dhe shërbimet në të njëjtën kohë.

Për qëllime të likuiditetit, Banka i klasifikon depozitat pa afat dhe depozitat e kursimit si detyrim sipas kërkesës dhe që maturohen brenda një muaji. Si rezultat, hendeku i maturimit të mbetur të likuiditetit deri në dymbëdhjetë muaj është rritur. Megjithatë, banka kryen teste të ndryshme stresi për të konfirmuar aftësinë për të mbuluar me likuiditet çdo situatë të mundshme të rëndë të tërheqjes së depozitave. Për më tepër, Banka ka një nivel të lartë të aktiveve likuide dhe një bazë financimi shumë të larmishëm me përqendrim shumë të ulët që zvogëlon më tej rrezikun e likuiditetit.

Banka po mban një portofol të aktiveve financiare shumë të tregtueshme që lehtë mund të likuidohen si mbrojtje ndaj çdo ndërprerjeje të paparashikuar të fluksit të mjeteve monetare. Drejtimi i Bankës po monitoron raportet e likuiditetit ndaj kërkesave të brendshme dhe rregullatore në baza ditore. Si rezultat, Drejtimi beson se Banka mund të përgjigjet si duhet ndaj flukseve monetare të mundshme brenda një afati të shkurtër.

9.3.1. Procesi i menaxhimit të rrezikut të likuiditetit

Administrimi i rrezikut të likuiditetit është një objektivi kryesor i Bankës i cili evoluon një gamë të gjerë aktivitetesh duke filluar nga monitorimi i ngushtë i pozicionit të tij të likuiditetit deri tek administrimi i burimeve të tij të financimit dhe përdorimi i fondeve, në një mënyrë që të mos kompromentojë aftësinë e Bankës për të përmbushur detyrimet e saj.

Banka ka miratuar praktikat më të mira dhe udhëzimet rregullatore/ mbikëqyrëse në përshkrimin e pozicionit të likuiditetit të Bankës dhe efektet e mundshme të ndryshimeve të pafavorshme që vijnë nga maturimi (dhe mosrinnovimi) i burimeve të saj të financimit, si dhe ulje të mundshme të vlerës së aktiveve të saj likuide. Ajo ushtron monitorim të ngushtë të kostos së likuiditetit dhe ka siguruar përputhjen me kornizën rregullatore të rrezikut të likuiditetit duke ruajtur dhe rishikuar rregullisht metodologjitë, politikat, procedurat dhe sistemet në mënyrë që të menaxhojë në mënyrë efektive rrezikun e likuiditetit.

Banka ka mbajtur nën vëzhgim të kujdesshëm nivelet e likuiditetit të saj duke siguruar që ato të qëndrojnë mbi minimumet rregullatore dhe kufijtë e brendshëm. Teste të shpeshta të stresit të cilat variojnë nga analiza e ndjeshmërisë e deri tek analiza e skenarit të fluksit të mjeteve monetare. Banka ka krijuar një plan financimi të detyrimeve të kushtëzuara, një plan të mirëpërcaktuar të rimëkëmbjes dhe ka përditësuar rregullisht kornizën e brendshme rregullatore që mbulon menaxhimin e rrezikut të likuiditetit.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***9. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****9.3. Rreziku i likuiditetit (vazhdim)****9.3.1. Procesi i menaxhimit të rrezikut të likuiditetit (vazhdim)**

Tabela më poshtë analizon aktivet dhe detyrimet në periudha kohore të caktuara bazuar në periudhën e mbetur në datën e raportimit deri në datën kontraktuale të maturimit. Aktivet dhe detyrimet në valutë të huaj konvertohen në LEK duke përdorur kursin e këmbimit valutor në fund të vitit. Supozimet e bëra janë që pagesat e planifikuara për bankën të respektohen plotësisht dhe në kohën e duhur dhe për më tepër, të gjitha pagesat kontraktuale të kryhen plotësisht – për shembull: depozituesit do të tërheqin paratë e tyre në vend që t'i rivendosin në bankë në datën e maturimit. Ato aktive dhe pasive që faktikisht nuk kanë data maturimi (për shembull llogari të hapura, llogari rrjedhëse, llogari kursimi) të përfshihen në një periudhë kohore fikse prej më pak se një muaj.

Më 31 dhjetor 2021	Më pak se një muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Nga 1 deri në 5 vite	Mbi 5 vjet	Totali
Aktive likuide						
Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qendrore	8,808,519	-	-	-	-	8,808,519
Depozita dhe llogari me bankat	3,400,028	-	-	-	-	3,400,028
Hua dhe paradhëniet për klientët, neto	3,068,988	3,132,583	11,480,876	9,594,461	17,531,808	44,808,716
Aktive financiare në VDATGJ	904,093	3,634,645	5,324,692	7,391,935	13,551,752	30,807,118
Aktive financiare me KA	-	-	-	847,922	4,739,670	5,587,591
Aktive të tjera	349,208	-	-	-	-	349,208
Totali i aktiveve financiare	16,530,837	6,767,228	16,805,568	17,834,318	35,823,229	93,761,181
Detyrime likuide						
Detyrime ndaj bankave	890,898	-	-	-	-	890,898
Detyrime ndaj klientëve	43,367,072	5,359,835	19,301,649	14,070,718	311,243	82,410,517
Borxhi i varur	-	-	-	-	607,176	607,176
Detyrime të tjera	1,592,823	-	162,436	319,844	-	2,075,103
Angazhimet e huasë	73,275	26,411	4,846,060	1,424,008	295,101	6,664,855
Letër garanci	1,169,806	-	-	-	-	1,169,806
Letër Krediti	116,413	-	-	-	-	116,413
Totali i detyrimeve financiare	47,210,287	5,386,246	24,310,145	15,814,570	1,213,520	93,934,768
Hendeku neto i likuiditetit	(30,679,449)	1,380,983	(7,504,578)	2,019,748	34,609,709	(173,587)

Të gjitha llogaritë rrjedhëse të klientëve të Bankës janë të përfshira në pasive që maturohen në më pak se një muaj. Llogaritë rrjedhëse paraqesin gjendjen që ka një histori dhe një devijim nga shuma që matet nga Banka dhe hendeku është më pak se ai negativ i paraqitur për periudhat fikse kohore të maturimit në më pak se një muaj. Çdo çështje që lind si pasojë e mospërpuljes së likuiditetit menaxhohet nëpërmjet veprimtarisë ndërbankare (huamarje, huadhënie) brenda linjave të para-miratuara të kredisë.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***9. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****9.3. Rreziku i likuiditetit (vazhdim)****9.3.1. Procesi i menaxhimit të rrezikut të likuiditetit (vazhdim)**

Tabela e mëposhtme tregon aktivet dhe detyrimet e Bankës nëpërmjet maturimit të mbetur kontraktual deri më 31 Dhjetor 2020:

Më 31 dhjetor 2020	Më pak se një muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Nga 1 deri në 5 vite	Mbi 5 vjet	Totali
Aktive likuide						
Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qendrore	6,972,818	-	-	-	-	6,972,818
Depozita dhe llogari me bankat	5,817,178	-	-	-	-	5,817,178
Hua dhe paradhëniet për klientët, neto	2,773,313	1,723,609	9,533,407	8,179,726	15,781,077	37,991,132
Aktive financiare në VDATGJ	1,719,472	2,795,150	5,290,371	8,320,656	8,308,361	26,434,010
Aktive financiare me KA	-	-	-	-	3,594,101	3,594,101
Aktive të tjera	175,404	-	-	-	-	175,404
Totali i aktiveve financiare	17,458,186	4,518,759	14,823,778	16,500,382	27,683,538	80,984,643
Detyrime likuide						
Detyrime ndaj bankave	1,835,171	1,460	13,893	10,175	-	1,860,698
Detyrime ndaj klientëve	37,761,618	5,229,232	17,144,028	11,133,454	300,981	71,569,313
Detyrime të tjera	439,219	-	105,987	131,124	-	676,330
Angazhimet për kreditë	13,377	12,691	4,420,254	92,521	235,832	4,774,676
Letër garanci	281,008	173,318	312,879	177,984	-	945,190
Letrat e Kredisë	-	7,422	-	-	-	7,422
Totali i detyrimeve financiare	40,330,393	5,424,123	21,997,042	11,545,258	536,813	79,833,629
Hendeku neto i likuiditetit	(22,872,208)	(905,364)	(7,173,264)	4,955,123	27,146,725	1,151,013

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

9. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

9.3. Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

9.3.1. Procesi i administrimit të rrezikut të likuiditetit (vazhdim)

Letrat e kredisë dhe garancitë e dhëna klientëve, angazhojnë Bankën të bëjë pagesa në emër të klientëve, të cilët janë të kushtëzuara në sajë për shkak të pamundësisë së klientit që të veprojë sipas afateve të kontratës. Angazhimet e huasë përfaqësojnë detyrimet kontraktuale për të dhënë hua të ripërtëritshme. Angazhimet në përgjithësi kanë datat e skadimit të përcaktuara, ose dispozita të tjera të përfundimit.

9.4. Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare

9.4.1 Parimet e vlerësimit

Vlera e drejtë është çmimi që do të merrej për të shitur një aktiv ose do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt në tregun kryesor (ose më të favorshëm) në datën e matjes në kushtet aktuale të tregut (d.m.th. një çmim daljeje), pavarësisht nga nëse ai çmim është drejtpërdrejt i vëzhgueshëm apo i vlerësuar duke përdorur një teknikë vlerësimi.

Për të treguar se si janë nxjerrë vlerat e drejta, instrumentet financiare klasifikohen bazuar në një hierarki të teknikave të vlerësimit, siç shpjegohet në Shënimin 6.4.

9.4.2 Drejtimi i vlerësimit

Metodologjia e vlerës së drejtë të Bankës dhe ajo drejtuese mbi modelet e saj përfshin një sërë kontrollesh dhe procedurash të tjera për të siguruar që janë vendosur masat e duhura mbrojtëse për të siguruar cilësinë dhe përshtatshmërinë e saj. Të gjitha iniciativat e produkteve të reja (përfshirë metodologjitë e tyre të vlerësimit) i nënshtrohen miratimeve nga funksione të ndryshme të Bankës, duke përfshirë funksionet e rrezikut dhe financave. Përgjegjësia e matjeve të vazhdueshme i takon sektorit të biznesit dhe linjës së produktit.

Pasi të dorëzohen, vlerësimet e vlerës së drejtë gjithashtu rishikohen dhe nga funksionet e Rrezikut dhe Financës. Procesi i pavarur i verifikimit të çmimeve për raportimin financiar është në fund të fundit përgjegjësi e ekipit të pavarur të verifikimit të çmimeve brenda Financës, i cili raporton tek Drejtuesi i Financës.

Ekipi i pavarur i verifikimit të çmimit (IPV) vërteton vlerësimet e vlerës së drejtë duke:

- Krahasuar i çmimet kundrejt çmimeve të vëzhgueshme të tregut ose burimeve të tjera të pavarura
- Ri-kryerja e llogaritjeve të modelit
- Vlerësimi dhe vërtetimi i parametrevave të hyrjes

Ekipi gjithashtu rishikon kalibrimin e modelit në të paktën një bazë tremujore ose kur ndodhin ngjarje të rëndësishme në tregjet përkatëse.

Ekipi i IPV-së punon së bashku me ekipin e politikave kontabël të funksionit të financave dhe është përgjegjës për të siguruar që shifrat përfundimtare të raportuara të vlerës së drejtë janë në përputhje me SNRF dhe do të propozojë rregullime kur të jetë e nevojshme.

Kur mbështeteni në burime të palëve të treta (p.sh. kuotat e ndërmjetësit, ose inpute të tjera mikro ose makroekonomike), ekipi i pavarur i verifikimit të çmimeve është gjithashtu përgjegjës për:

- Verifikimin e listës së miratuar të ofruesve
- Kuptimin e metodologjive të vlerësimit dhe burimeve të inputeve dhe verifikimi i përshtatshmërisë së tyre për kërkesat e raportimit sipas SNRF-ve

Teknikat e vlerësimit dhe konsideratat specifike për inputet e Nivelit 3 shpjegohen më tej në shënimin 9.4.4.

9.4.3 Instrumentet financiare të mbajtura me kosto të amortizuar

SNRF 13 përcakton vlerën e drejtë si çmimin që do të merrej për të shitur një aktiv ose për të paguar transferimin e një detyrimi në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. Vlerat e drejta janë bazuar në supozimet e drejtimit në përputhje me profilin e bazës së aktivitetit dhe detyrimit.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***9. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****9.3. Rreziku i likuiditetit (vazhdim)****9.4. Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)****9.4.3 Instrumentet financiare të mbajtura me kosto të amortizuar (vazhdim)**

Tabela më poshtë përmbledh vlerat kontabël dhe vlerat e drejta të atyre aktiveve dhe detyrimeve financiare që nuk paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës me vlerën e tyre të drejtë.

	Vlera kontabël neto		Vlera e drejtë	
	2021	2020	2021	2020
Aktive financiare				
Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qendrore	8,808,519	6,972,818	8,808,519	6,972,818
Depozita dhe llogari me bankat	3,400,028	5,817,178	3,400,028	5,817,178
Hua dhe paradhënie për klientët	44,808,715	37,991,132	44,823,380	37,891,892
Aktive financiare me KA	5,587,591	3,594,101	5,578,927	3,594,101
Detyrimet financiare				
Detyrime ndaj klientëve	82,410,517	71,569,313	82,546,680	71,513,250
Detyrime ndaj bankave	890,898	1,860,698	890,898	1,860,698
Borxhi i varur	607,176	-	608,857	-

a) Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qendrore, Depozita dhe llogari me bankat

Vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe llogarive me Bankën Qendrore është afërsisht e barabartë me vlerën kontabël, për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër. Huatë dhe paradhëniet ndaj bankave përfshijnë depozitat ndërbankare. Vlera e drejtë e depozitave ndërbankare me normë fikse dhe depozitave njëditore është vlera kontabël e tyre. Vlera e drejtë e vlerësuar e depozitave me interes fikse bazohet në flukset e mjeteve monetare të zbritura duke përdorur norma interesi mbizotëruese të tregut të parave për borxhet me rrezik të ngjashëm kredie dhe me maturim të mbetur. Për sa i përket depozitave në banka, këto janë depozita afatshkurtra, për të cilat norma e interesit kontabël nuk ndryshon shumë nga norma e interesit të tregut më 31 dhjetor 2021 dhe 2020.

b) Hua dhe paradhënie për klientët

Huatë dhe paradhëniet janë neto nga shtesat për zhvlerësim. Për vitin 2021, vlera e drejtë e kredisë dhe e paradhënieve për klientët është afërsisht e barabartë me vlerën e tyre kontabël për shkak të faktit se pjesa kryesore e portofolit të kredisë mbart norma interesi të luhatshme të cilat pasqyrojnë ndryshimet në kushtet e tregut. Vlera e drejtë e huave dhe paradhënieve për klientët është fluksi i pritshëm i mjeteve monetare i zbritur sipas normave të tregut aktual. Normat e tregut aktual janë normat e interesit që Banka do të ngarkonte në këtë moment (fondi i vitit).

c) Aktive financiare me kosto të amortizuar

Mjetet financiare me kosto të amortizuar përfshijnë obligacione të emetuara nga qeveria shqiptare në lekë dhe obligacione të korporatave të emetuara nga bankat greke në euro, të cilat blihen me qëllim mbajtjen deri në maturim. Çmimet e kuotuar në tregjet aktive nuk ishin të disponueshme për obligacionet shtetërore të emetuara në lekë. Megjithatë, kishte informacion të mjaftueshëm në dispozicion për të matur vlerën e drejtë të këtyre letrave me vlerë bazuar në inputet e vëzhgueshme të tregut. Prandaj, sa herë që ekzistojnë çmimet e kuotuar, letrat me vlerë përfshihen në Nivelin 1 të hierarkisë së vlerës së drejtë (d.m.th. obligacionet e korporatave - përdorimi i çmimit të kuotuar në një treg aktiv për atë instrument).

d) Detyrime ndaj bankave dhe klientëve

Vlera e drejtë e vlerësuar e depozitave me maturitet të padeklaruar, që përfshin depozitat pa interes, është shuma e ripagueshme sipas kërkesës.

Vlera e drejtë e vlerësuar e depozitave me norma interesi fikse dhe huamarrje të tjera të pakuotuar në një treg aktiv bazohet në flukset e skontuara monetare duke përdorur norma interesi për borxh të ri me maturitet të mbetur të ngjashëm. Në fund të vitit 2020 dhe 2021, Drejtimi vlerëson se vlera e drejtë e detyrimeve ndaj klientëve përaftron vlerën kontabël, sepse gjatë vitit 2021 Banka ka lëshuar norma interesi për depozitat e klientëve të ngjashme me tregun.

Detyrimet ndaj bankave kryesisht i referohen huamarrjes së tregut me një maturim prej një muaji nga data e bilancit dhe për këtë arsye vlera e drejtë e tyre konsiderohet se përaftron vlerën kontabël.

e) Borxhi i varur

Vlera e drejtë e borxhit të varur është vlerësuar duke përdorur një model të skontuar të fluksit monetar të bazuar në një kurbë kthimi aktual të interesit të përshtatshme për periudhën e mbetur deri në maturim sipas normës më të fundit të tregut për instrumente të ngjashme (maturimi dhe valuta). Borxhi i varur përdoret si input i nivelit 3 në hierarkinë e vlerës së drejtë.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***9. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****9.4. Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)***9.4.4 Instrumentet financiare të matura me vlerën e drejtë*

Matjet e vlerës së drejtë analizohen sipas nivelit të hierarkisë së vlerës së drejtë si më poshtë:

(i) Niveli 1 janë matjet me çmime të kuotuarra (të parregulluara) në tregjet aktive për aktive ose detyrime identike;

(ii) Matjet e Nivelit 2 janë teknika vlerësimi me të gjitha inputet materiale të vëzhguara për aktivin ose detyrimin, ose të drejtpërdrejta (d.m.th. si çmime) ose jo të drejtpërdrejta (d.m.th. që rrjedh nga çmimet); dhe

(iii) Matjet e nivelit 3 janë vlerësime që nuk bazohen në të dhëna të mbikëqyrura të tregut (d.m.th. inputet e pambikëqyrura).

Drejtimi aplikon gjykimin në kategorizimin e instrumenteve financiare duke përdorur hierarkinë e vlerës së drejtë. Nëse një matje e vlerës së drejtë përdor inputet e vëzhguara që kërkojnë rregullim të konsiderueshëm, ajo matje është një matje e Nivelit 3. Rëndësia e një inputi vlerësimi vlerësohet përkundrejt matjes së vlerës së drejtë në tërësinë e tij. Matjet e përsëritura të vlerës së drejtë janë ato matje që kërkohen ose lejohen në pasqyrën e pozicionit financiar nga standardet e kontabilitetit në fund të çdo periudhe raportimi. Vlerat e drejta të analizuara sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë dhe vlerës kontabël të aktiveve jo të matura me vlerën e drejtë janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2021			
	Vlera kontabël	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
AKTIVE FINANCIARE				
Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qëndrore	8,808,519	-	6,937,382	1,871,137
Detyrime nga Bankat	3,400,028	-	-	3,400,028
Hua dhe paradhënie për klientët	44,808,715	-	-	44,823,380
Letrat me vlerë të investimeve në VDATGJ	30,807,125	10,136,731	20,670,393	-
Aktive financiare me kosto të amortizuar	5,587,591	3,519,101	2,059,826	-
DETYRIME FINANCIARE				
Llogaritë e klientëve	82,410,517	-	-	82,546,680
Detyrime ndaj bankave	890,898	-	-	890,898
Borxhi i varur	607,176	-	-	608,857
			31 dhjetor 2020	
	Vlera kontabël	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
AKTIVE FINANCIARE				
Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qendrore	6,972,818	-	5,768,788	1,204,031
Detyrime nga Bankat	5,817,178	-	-	5,817,178
Hua dhe paradhënie për klientët	37,991,132	-	-	37,891,892
Letrat me vlerë të investimeve në VDATGJ	26,434,010	6,444,397	19,989,613	-
Aktive financiare me kosto të amortizuar	3,594,101	3,594,101	-	-
DETYRIME FINANCIARE				
Llogaritë e klientëve	71,569,313	-	-	71,513,250
Detyrime ndaj bankave	1,860,698	-	-	1,860,698

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***9. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****9.5. Administrimi i kapitalit**

Objektivat e Bankës në administrimin e kapitalit që është një koncept më i gjerë se "kapitali" në bilanc, janë:

- Të jetë në përputhje me kërkesat për kapital të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë;
- Të ruajë aftësinë e bankës për të vazhduar në vijimësi në mënyrë që të mund të vazhdojë të sigurojë kthim për aksionarët dhe përfitime për grupet e tjera të interesit; dhe
- Të ruajë një bazë të fortë kapitali për të mbështetur zhvillimin e biznesit të saj.

Mjaftueshmëria e kapitalit dhe përdorimi i kapitalit rregullator monitorohen nga drejtimi i Bankës, duke përdorur teknika të bazuara në udhëzimet e hartuara nga Komiteti i Bazelit dhe Direktivat e Komunitetit Evropian, të implementuara nga Banka e Shqipërisë, për qëllime mbikëqyrëse. Informacioni i kërkuar dërgohet në Bankën e Shqipërisë çdo tre muaj. Banka ka krijuar procedura të brendshme në përputhje me rregulloren e "Raportit të Mjaftueshmërisë të Kapitalit", për vlerësimin dhe monitorimin e kërkesës për kapital dhe mjaftueshmërisë së kapitalit.

Administrimi dhe planifikimi i kapitalit, siguron qëndrueshmërinë e Bankës në kushte normale dhe të stresuar të mjedisit ekonomik dhe financiar, duke marrë parasysh rreziqet ndaj të cilave ekspozohet Banka. Synimet për kapital janë përcaktuar për të siguruar një stabilitet të mjaftueshëm për të mbrojtur depozituesit, si dhe për të mbështetur vazhdimësinë e biznesit, duke mbajtur një amortizator komforti përgjatë kërkesave rregulatore. Administrimi i kapitalit është gjithashtu një pjesë përbërëse e Procesit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë të Kapitalit i cili synon të vlerësojë kërkesat për kapital në përputhje me profilin dhe strategjinë e riskut të Bankës.

Banka e Shqipërisë kërkon që bankat të: (a) mbajnë nivelin minimal të kapitalit rregullator prej 1 miliardë lekësh dhe (b) të ruajnë një raport të totalit të kapitalit rregullator ndaj aktivitetit të ponderuar nga rreziku ("raporti i Bazelit") në ose mbi minimumin e kërkuar të Bankës së Shqipërisë prej 12% (2020: 12%). Banka e Shqipërisë ka kërkuar specifikisht që Tirana Bank të ruajë një raport minimal të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 15%, deri në shkurt 2022, dhe një raport minimal prej 13.5% pas kësaj date.

Kapitali rregullator është kapitali i Bankës, i llogaritur në përputhje me kërkesat e rregullores së Bankës së Shqipërisë, për të mbuluar rrezikun e kredisë, rrezikun e tregut dhe rrezikun operacional. Kapitali rregullator i Bankës është i ndarë në dy nivele. Banka llogarit kapitalin rregullator si shumën e kapitalit të nivelit të parë dhe kapitalit të nivelit dytë, duke marrë parasysh zbritjet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregulloret e Bankës së Shqipërisë. Bankat llogarisin ekspozimet e ponderuara të riskut si shuma të elementeve të mëposhtëm:

- a) Zërat e ekspozimeve dhe ekspozimet e mundshme të ponderuara për kredinë, ose rrezikun e palëve homologe;
- b) Kërkesat kapitale për rreziqet e tregut; dhe
- c) Kërkesat kapitale për rrezikun operacional.

Tabela e mëposhtme përmbledh përbërjen e kapitalit rregullator dhe raporteve të Bankës për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2021 dhe 2020. Mjaftueshmëria e kapitalit të Bankës administrohet nga Departamenti i Riskut. Gjatë këtyre dy viteve, Banka ka përbushur të gjitha kërkesat e kapitalit të imponuar nga jashtë.

	2021	2020
Kapitali i Nivelit 1		
Kapitali aksionar	7,653,589	7,653,589
Rezervat	1,426,705	1,394,292
Fitimi i periudhës*	1,020,795	354,313
Diferencat e rivlerësimit për raportimin statutor	(901,299)	(736,909)
Totali i kapitalit të Nivelit 1 kualifikues	9,199,789	8,665,285
Kapitali i Nivelit 2		
Borxhi i varur	607,176	-
Zbritjet nga kapitali rregullator	(137,664)	(839,838)
Totali i kapitalit të Nivelit 2 kualifikues	469,512	(839,838)
Totali i kapitalit rregullator	9,669,302	7,825,446
Aktivitet totale të ponderuara nga risku	55,448,754	48,522,328
Raporti RMK	17.44%	16.13%

Fitimi i vitit aktual është përfshirë si një element i Kapitalit të Përbashkët të Nivelit 1 pasi të jenë certifikuar dhe raportuar tek rregullatori pasqyrat financiare të audituara dhe pasi çdo dividendi të ndërmjetëm (të pjesshëm) të paguar gjatë vitit, tatimet dhe detyrimet e tjera mbi fitimin të jenë zbritur. Pas përfshirjes së fitimit të vitit aktual, Drejtimi vlerëson që raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të bëhet 18,12% në 31 dhjetor 2021 (2020: 17,32%).

* Fitimi i periudhës konsiston në fitimin e kapitalizuar gjatë vitit

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***10. Të ardhurat nga interesi dhe të ngjashme**

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga huatë dhe paradhëniet për klientët	1,979,124	1,754,391
Të ardhura nga aktivet financiare në VDATGJ	1,185,731	1,085,680
Të ardhura nga llogaritë në banka	11,228	15,069
Totali i Interesit dhe të ardhurave të ngjashme	3,176,083	2,855,140

11. Shpenzimet nga interesi dhe te ngjashme

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Shpenzime interesi për detyrimet ndaj klientëve	221,090	218,938
Shpenzime interesi për detyrimet ndaj bankave	48,476	31,601
Shpenzime interesi për borxhin e varur	13,476	-
Shpenzime interesi për detyrimet e qirasë	303	369
Totali i Interesit dhe shpenzimeve të ngjashme	283,345	250,908

12. Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
<i>Të ardhura nga tarifat e shërbimeve që ofrohen gjatë një periudhe të caktuar kohore</i>		
Tarifa e mirëmbajtjes së llogarive	166,177	167,324
Shërbime të tjera Bankare	120,457	95,362
Komisioni nga Visa Card	110,178	112,482
<i>Të ardhura nga tarifa e ofrimit të shërbimeve financiare dhe të fituara me kryerjen e një transaksioni</i>		
Transferta dhe pagesa	95,511	83,324
Import/Eksport	13,596	15,992
Letra Krediti dhe të tjera	11,872	14,407
Totali i të ardhurave nga tarifat dhe komisionet	517,792	488,892
Kartat e kreditit	(21,580)	(14,053)
Shërbime bankare	(1,628)	(1,558)
Bankat korrespondente	(4,818)	(3,332)
Totali i shpenzimeve nga tarifat dhe komisionet	(28,026)	(18,944)
Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet	489,766	469,948

13. Humbjet të pritshme nga zhvlerësimi / (rikuperimi) i paradhënieve ndaj Bankave, letrave me vlerë dhe zërave jashtë bilancit

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Bankat	(85)	(499)
Aktive financiare në VDATGJ	9,270	(118,077)
Aktive financiare me kosto të amortizuar	94,440	(148,232)
Zërat jashtë bilancit	(95,559)	39,308
Totali	8,066	(227,500)

14. Shpenzime personeli

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Paga dhe shpërblime	693,027	610,795
Kontributet e fondeve të pensionit	89,207	76,291
Shpenzime të tjera të personelit	11,816	13,374
Totali	794,050	700,460

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***15. Shpenzime të tjera operative**

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Tarifa për sigurimin e depozitave (ASD)	224,941	212,978
Shpenzimet të sigurisë dhe mirëmbajtjes	217,408	203,132
Shpenzime që lidhen me kartën	134,764	111,344
Shpenzime për komisionet dhe shpenzime të ngjashme	85,082	101,955
Shpenzime të telekomunikacionit	59,383	65,179
Reklamat dhe marketingu	48,380	44,729
Shpenzime për palët e treta	35,004	43,637
Fondi i rezolutës së bankave	33,460	37,130
Shpenzimet e shërbimeve utilitare	33,297	31,517
Tatime (duke përfshirë tatim fitimit)	19,883	18,811
Shpenzime ligjore	16,746	19,885
Kancelari dhe të konsumueshme	16,330	15,890
Shpenzime të tjera të sigurimit	8,657	14,355
Shpenzime udhëtimi	8,418	8,858
Shpenzime auditimi	7,319	7,778
Shpenzime të tjera	53,170	67,181
	1,002,243	1,004,359

16. Tatimi mbi fitimin

Përbërësit e shpenzimit të tatimit për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 janë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
<i>Tatim fitimi aktual</i>		
Shpenzimi i tatimit aktual	(215,473)	(172,983)
<i>Taksa e shtyrë</i>		
Lidhur me origjinën dhe anulimin e diferencave të përkohshme	3,833	(3,637)
Shpenzimi i tatimit që raportohet në fitim ose humbje	(211,641)	(176,621)

Rikonsilimi midis shpenzimit tatimor dhe fitimit kontabël të shumëzuar me normën e tatimit të brendshëm të Shqipërisë për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Humbja) / fitimi kontabël përpara tatimit sipas pasqyrave financiare të SNRF-ve	1,076,670	824,889
Tatim fitimi teorik me normë statutores 15% (2020: 15%)	161,500	123,733
Efekt i tatimor i diferencave të përhershme:	53,972	49,123
-Fitimi i cili është përfshirë nga taksat	(6,506)	(6,722)
-Shpenzime të pazbritshme	60,479	55,972
Humbje të vitit aktual për të cilat nuk është njohur aktiv tatimor i shtyrë	215,473	172,983
Shpenzimi i tatimit aktual	215,473	172,983
<i>Tatimi i shtyrë</i>		
Zëra të tjerë të tatimit të shtyrë	3,833	(3,637)
Të ardhura të tatimit të shtyrë që raportohen në fitim ose humbje	3,833	(3,637)
Aktive financiare në VDATGJ	5,125	59,290
Shpenzimi i tatimit të shtyrë që raportohet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	5,125	59,290

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***16. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)**

Norma efektive e tatimit mbi fitimin mbi te ardhurat për vitin 2021 është 17% (2020: 22%).

Tatim fitimi i pagueshëm/ (i arkëtueshëm)	2021	2020
Tatim fitimi (i arkëtueshëm) që nga 1 janari	415	30,846
Tatimi fitimi i parapaguar (afati në fund të periudhës paraardhëse)	(415)	(30,846)
Tatimi fitimi i parapaguar në Tatime	(227,620)	(172,568)
Tatimi fitimin aktual	215,473	172,983
Tatim fitimi i pagueshëm / (i arkëtueshëm) më 31 dhjetor	(12,147)	415

Tatimi i shtyrë i përfshirë në bilanc dhe ndryshimet e regjistruara në shpenzimet e tatimit fitimit janë si më poshtë:

	2021			Aktivet financiare të disponueshme për shitje Rezerva
	Taksa e shtyrë Aktivet	Taksa e shtyrë Detyrimet	Të ardhurat Pasqyrat (Dr)/Cr	
Aktivet financiare në VDATGJ	-	(58,723)	-	5,125
Zëra të tjerë të tatimit të shtyrë	81,676	-	(3,833)	-
Totali	81,676	(58,723)	(3,833)	5,125
Detyrime tatimore të shtyra, neto	22,952			

	2020			Aktivet financiare të disponueshme për shitje Rezerva (Dr)/Cr
	Taksa e shtyrë Aktive	Taksa e shtyrë Detyrimet	Të ardhurat Pasqyrat (Dr)/Cr	
Aktivet financiare në VDATGJ	-	(63,848)	-	59,290
Zëra të tjerë të tatimit të shtyrë	77,843	-	(3,637)	-
Totali	77,843	(63,848)	(3,637)	59,290
Aktive tatimore të shtyra, neto	13,995			

Ndërsa më 31 dhjetor 2021 dhe 2020, zërat e tjerë të tatimit të shtyrë, përfshijnë aktivet/ detyrimet tatimore të shtyra si rezultat i diferencave të përkohshme midis vlerës kontabël dhe bazës tatimore në datën e bilancit të komisioneve të aktiveve afatgjata materiale dhe huave.

17. Te ardhura te tjera, neto

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
Rikuperimet nga kreditë e fshira më parë	166,972	92,514
Fitimet nga shitja e kolateraleve të riposduara, neto	18,582	37,620
Të ardhura të tjera	47,401	72,973
Totali	232,955	203,107

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumatat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***18. Mjetet monetare dhe llogaritë me Bankën Qendrore**

	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
Mjete monetare në arkë		
Shënime dhe monedha në LEK	975,134	662,891
Shënime dhe monedha në valutë të huaj	896,004	541,140
	1,871,137	1,204,031
Llogaritë me Bankën Qendrore		
Llogaria rrjedhëse		
në LEK	469,697	386,324
në valutë të huaj	52	40
	469,749	386,364
Rezervat e detyrueshme		
në LEK	1,902,380	1,823,001
në valutë të huaj	4,567,119	3,560,639
	6,469,499	5,383,640
Interesi i përlogaritur	(1,842)	(1,204)
Humbje të pritshme kreditore	(25)	(12)
Totali i llogarive me Bankën Qendrore	6,937,382	5,768,788
Totali i mjeteve monetare dhe llogarive me Bankën Qendrore	8,808,519	6,972,818

E përfshirë në llogaritë me Bankën Qendrore është rezerva ligjore për qëllime të likuiditetit, e cila përfaqëson një depozitë rezervë minimale, të kërkuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë. Rezervat statutorë u llogariten si mëposhtë:

Raporti i rezervës në LEK është:

- 7.5% për detyrimet e përfshira në bazën e rezervës dhe me një afat maturimi deri në 12 muaj.
- 5.0% për detyrimet e përfshira në bazën e rezervës dhe me një afat fillestar maturimi mbi 12 muaj deri në 2 vjet.

Raporti i rezervës në valutë është:

- 12.5% për detyrimet e përfshira në bazën e rezervës, ku raporti i "detyrimeve në monedhën përkatëse/ totali i detyrimeve" të Bankës është deri në 50 (pesëdhjetë) përqind".
- 20% për detyrimet e përfshira në bazën e rezervës, ku raporti i "detyrimeve në monedhën përkatëse / totali i detyrimeve" të Bankës është më i lartë se 50 (pesëdhjetë) përqind".

Banka duhet të mbajë rezervat e saj minimale në llogaritë e rezervës në Bankën e Shqipërisë. Gjatë periudhës së mirëmbajtjes, Banka mund të përdorë vetëm rezervën minimale në LEK, me kusht që mesatarja e rezervës së bankës në ditën e fundit të periudhës së mirëmbajtjes të mos bjerë nën nivelin e kërkuar të rezervës. Niveli i rezervave, i përdorur mbi baza ditore nga Banka, shprehet si përqindje dhe vendoset nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Duke filluar nga data 24 Shkurt 2018, raporti është 70 përqind e rezervave minimale të kërkuara.

Mjetet monetare dhe llogaritë me Bankën Qendrore, duke përjashtuar mjetet monetare në arkë, përfshihen në analizën e ekspozimit maksimal ndaj rrezikut të kredisë (Shënimi 9.1.5).

Interesi i rezervës statutorë në Bankën Qendrore llogaritet si më poshtë:

2021			
Monedha	Minimumi	Maksimumi	Metoda e llogaritjes
LEK	0.50%	0.50%	100% e nivelit të huasë bazë
USD	-	-	n.a
EURO	-0.50%	-0.50%	Norma e interesit e ECB në depozitë
2020			
Monedha	Minimum	Maximum	Metoda e llogaritjes
LEK	0.50%	1.00%	100% e nivelit të huasë bazë
USD	-	-	n.a
EURO	-0.50%	-0.50%	Norma e interesit e ECB në depozitë

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***19. Depozita dhe llogari me bankat**

	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
Llogaritë rrjedhëse		
(Nostro) dhe depozita pa afat	2,254,915	2,208,726
Totali i llogarive rrjedhëse	2,254,915	2,208,726
Depozita ndërbankare		
Depozita ndërbankare – jo vendase	1,145,210	3,608,670
Interesi i përlogaritur	(1)	(21)
Totali i depozitave ndërbankare	1,145,209	3,608,649
Zhvlerësimi i depozitave dhe llogari me bankat	(96)	(197)
Totali i depozitave dhe llogari me bankat	3,400,028	5,817,178

Llogaritë rrjedhëse me bankat janë pa interesa. Normat e interesit për nostros dhe depozitat pa afat janë të luhatshme. Nostro dhe Depozitat pa afat janë të detajuara në tabelën e mëposhtme:

	S&P LT/ST	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	S&P LT/ST	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Nostro dhe Depozita pa afat				
Raiffeisen Bank International AG	A-	3,604	BBB+	104,478
Deutsche Bank AG	A-	1,419,104	BBB+	1,918,511
Deutsche Bank Trust Bank Americas	A-	623,689	BBB+	181,050
Piraeus Bank SA	B-	208,517	B-	4,688
Totali		2,254,915		2,208,726

31 dhjetor 2021	S&P LT/ST	Monedha	Monedha fillestare	Në Lek '000
SANPAOLO DI TOR	BBB	GBP	4,600,000	662,170
ALFA BANK GREQI	B-	EUR	4,000,000	483,040
Interesi i përlogaritur				(1)
Totali				1,145,209

31 dhjetor 2020	S&P LT/ST	Monedha	Monedha fillestare	Në Lek '000
SANPAOLO DI TORINO	BBB	USD	13,000,029	1,310,920
ALFA BANK GREECE	BB	EUR	12,999,801	1,608,100
SANPAOLO DI TORINO	BBB	GBP	5,000,001	689,650
Interesi i përlogaritur				(21)
Totali				3,608,649

Tabela më poshtë paraqet ndryshimet në provizionin për humbjet e borxhit nga Bankat dhe arsyet e këtyre ndryshimeve gjatë vitit 2021:

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali
Provizion për humbjen deri më 1 janar 2021	197	-	-	-	197
Lëvizjet me ndikim në fitim ose humbje:					
Transferimet midis Fazave	-	-	-	-	-
Aktive të reja financiare të origjinuara ose të blera	91	-	-	-	91
Ndryshime në PD/ HD/ ED	(188)	-	-	-	(188)
Ndryshimet në supozime dhe metodologji / modifikimi/ fshirjet/ FX/ të tjera.	-	-	-	-	-
Totali neto i fitimit ose humbjes gjatë periudhës	(97)	-	-	-	(97)
Lëvizje të tjera pa ndikim në fitim ose humbje	4	-	-	-	4
Aktivitet financiarë të çregjistruara gjatë periudhës	-	-	-	-	-
Provizion për humbjen më 31 dhjetor 2021	96	-	-	-	96

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***19. Depozita dhe llogari me bankat (vazhdim)**

Tabela si më poshtë tregon ndryshimet në provizionin për humbjet e detyrimeve nga Bankat dhe arsyet e këtyre ndryshimeve gjatë vitit 2020:

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali
Provizion për humbjen deri më 1 janar 2020	543	-	-	-	543
Lëvizjet me ndikim në fitim ose humbje:					
Transferimet midis Fazave	-	-	-	-	-
Aktive të reja financiare të origjinuara ose të blera	196	-	-	-	196
Ndryshime në PD/ HD/ ED	(547)	-	-	-	(547)
Ndryshimet në supozime dhe metodologji / modifikimi / fshirjet/ FX/ të tjera.	-	-	-	-	-
Totali neto i fitimit ose humbjes gjatë periudhës	(351)	-	-	-	(351)
Lëvizje të tjera pa ndikim në fitim ose humbje	5	-	-	-	5
Aktivitetet financiare të çregjistruara gjatë periudhës	-	-	-	-	-
Provizion për humbjen më 31 dhjetor 2020	197	-	-	-	197

Ndryshimet në vlerën kontabël bruto të Bankës gjatë vitit 2021 që kanë kontribuar në ndryshime në provizionin për humbjet janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali
Vlera kontabël bruto që nga 1 janari 2021	5,817,375	-	-	-	5,817,375
Transferimi midis Fazave	-	-	-	-	-
Aktive financiare të çregjistruara gjatë një periudhe përveç fshirjeve	-	-	-	-	-
Aktive të reja financiare të origjinuara ose të blera	1,145,209	-	-	-	1,145,29
Modifikimi i flukseve monetare kontraktuale të aktiveve financiare; Ndryshimet në të drejtat dhe detyrimet e konstatuara të interesit; Fshirjet; FX dhe lëvizjet e tjera	(3,562,460)	-	-	-	(3,562,460)
Vlera kontabël bruto që nga 31 dhjetor 2021	3,400,124	-	-	-	93,400,124

Ndryshimet në vlerën kontabël bruto të Depozitave dhe llogarive me Bankat gjatë vitit 2020 që kanë kontribuar në ndryshime në provizionin për humbjet janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali
Vlera kontabël bruto që nga 1 janari 2020	3,897,324	-	-	-	3,897,324
Transferimi midis Fazave	-	-	-	-	-
Aktive financiare të çregjistruara gjatë një periudhe përveç fshirjeve	-	-	-	-	-
Aktive të reja financiare të origjinuara ose të blera	3,616,197	-	-	-	3,616,197
Modifikimi i flukseve monetare kontraktuale të aktiveve financiare; Ndryshimet në të drejtat dhe detyrimet e konstatuara të interesit; Fshirjet; Efekti nga kursi i këmbimit dhe lëvizjet e tjera	(1,696,146)	-	-	-	(1,696,146)
Vlera kontabël, bruto që nga 31 dhjetor 2020	5,817,375	-	-	-	5,817,375

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***20. Huatë dhe paradhëniet për klientët, neto**

	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
Hua për korporata	25,696,792	24,692,553
Hua për SME	5,705,743	2,464,790
Totali i huave për Korporata dhe SME	31,402,535	27,157,343
Hua konsumatore	3,345,182	2,915,109
Kredi Hipotekore	11,484,232	9,420,237
Overdraftet	397,151	358,399
Kartat e kreditit	186,459	179,095
Komisionet e shtyra të huasë përmes EIR	(121,319)	(94,454)
Interesi u përlogaritur	123,104	109,427
Huatë dhe paradhëniet bruto	46,817,345	40,045,156
Minus: Humbjet e pritshme nga zhvlerësimi	(2,008,629)	(2,054,024)
Totali	44,808,715	37,991,132
Afatshkurtër	17,682,447	14,030,329
Afatgjatë	27,126,269	23,960,803

Tabela më poshtë tregon analizën e industrisë së kredive bruto (pa marrë parasysh "komisionet e huasë të shtyra" dhe "interesin e përlogaritur") të dhënë për klientët e korporatave dhe SME.

	2021	2020
Prodhimi	6,106,747	3,953,814
Elektriciteti	2,813,377	2,498,789
Tregtia	6,882,921	6,308,105
Ndërtim	5,818,898	3,248,999
Ndërmjetësimi financiar	2,453,874	2,440,000
Industritë e tjera	7,326,719	8,707,637
Huatë totale bruto	31,402,535	27,157,343

Normat e interesit për huatë dhe paradhëniet për klientët janë luhatëse dhe paraqiten si më poshtë:

Monedha	2021	2020
LEK	12 muaj TRIBOR + (0.5% - 10.5%)	12 muaj TRIBOR + (1% - 8.5%)
USD	12 muaj LIBOR + (1% - 7%)	12 muaj LIBOR + (4% - 7%)
EURO	12 muaj EURIBOR+ (0.5% - 12%)	12 muaj EURIBOR+ (2% - 9%)

Lëvizja e zhvlerësimit për humbjet nga huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve është si më poshtë:

	2021	2020
Zhvlerësimi per HPK më 1 janar	2,054,024	1,771,400
Zhvlerësimi i vitit, neto nga rikuperimet	84,037	603,715
Fshirje	(105,355)	(332,605)
Efekt i kursit të këmbimit	(24,077)	11,514
Zhvlerësimi per HPK më 31 dhjetor	2,008,629	2,054,024
Zhvlerësimi i huave dhe paradhënieve për klientët	84,037	603,715
Rikuperime nga kredi të fshira më parë (Shenimi 17)	(166,972)	(92,514)
Totali i fitimit ose humbjes neto përgjatë periudhës	(82,935)	511,201
Zhvlerësime individuale	683,870	773,091
Zhvlerësime kolektive	1,324,759	1,280,933
	2,008,629	2,054,024

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumatat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***20. Huatë dhe paradhëniet për klientët, neto (vazhdim)**

Në përputhje me SNRF 9 më poshtë janë paraqitur ndryshimet në provizionin për humbjen nga huatë dhe paradhëniet për klientët dhe arsyet e këtyre ndryshimeve gjatë vitit 2021 dhe 2020, sipas kategorisë së kredisë. Në tabelën përmbledhëse më poshtë është paraqitur një shpjegim se si ndryshimet në vlerën kontabël bruto të huave dhe paradhënieve për klientët gjatë periudhës kontribuuan në ndryshime në provizionin për humbjen gjatë periudhës së përfunduar më 31 dhjetor 2021 dhe 2020.

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali
HPK deri më 1 janar 2021	463,721	307,921	1,282,381	-	2,054,024
Lëvizjet me ndikim në fitim ose humbje					
Transferimet:	154,176	(162,073)	7,897	-	-
Transferimet: nga Faza 1 në Fazën 2	(13,745)	13,745	-	-	-
Transferimet: nga Faza 1 në Fazën 3	(1,366)	-	1,366	-	-
Transferimet: nga Faza 2 në Fazën 1	165,927	(165,927)	-	-	-
Transferimet: nga Faza 2 në Fazën 3	-	(32,495)	32,495	-	-
Transferimet: nga Faza 3 në Fazën 1	3,360	-	(3,360)	-	-
Transferimet: nga Faza 3 në Fazën 2	-	22,604	(22,604)	-	-
Aktive të reja financiare të origjinuara ose të blera	100,213	10,699	141,021	-	251,932
Ndryshime në PD / HD / ED	(34,511)	(26,525)	(67,071)	-	(128,106)
Fshirje	-	-	(206,761)	-	(206,761)
Totali neto i fitimit ose humbjes gjatë periudhës	219,879	(177,899)	(124,914)	-	(82,934)
Lëvizje të tjera pa ndikim në fitim ose humbje	(161,668)	86,508	112,700	-	37,540
Çregjistrimi gjatë periudhës	-	-	-	-	-
HPK për humbjen më 31 dhjetor 2021	521,932	216,530	1,270,167	-	2,008,629

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali
HPK deri më 1 janar 2020	310,772	115,921	1,344,707	-	1,771,400
Lëvizjet me ndikim në fitim ose humbje					
Transferimet:	28,048	(9,786)	(18,262)	-	-
Transferimet: nga Faza 1 në Fazën 2	(6,164)	6,164	-	-	-
Transferimet: nga Faza 1 në Fazën 3	(847)	-	847	-	-
Transferimet: nga Faza 2 në Fazën 1	34,149	(34,149)	-	-	-
Transferimet: nga Faza 2 në Fazën 3	-	(17,662)	17,662	-	-
Transferimet: nga Faza 3 në Fazën 1	910	-	(910)	-	-
Transferimet: nga Faza 3 në Fazën 2	-	35,860	(35,860)	-	-
Aktive të reja financiare të origjinuara ose të blera	234,619	150,489	225,306	-	610,413
Ndryshime në PD / HD / ED	40,088	(30,570)	131,354	-	140,872
Fshirje	-	-	(240,088)	-	(240,088)
Totali neto i fitimit ose humbjes gjatë periudhës	302,755	110,132	98,311	-	511,198
Lëvizje të tjera pa ndikim në fitim ose humbje	(149,806)	81,868	(160,637)	-	(228,575)
Çregjistrimi gjatë periudhës	-	-	-	-	-
HPK për humbjen më 31 dhjetor 2020	463,721	307,921	1,282,381	-	2,054,023

Nuk ka hua POCI dhe të çregjistruara gjatë 2021 dhe 2020.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***20. Huatë dhe paradhëniet për klientët, neto (vazhdim)**

Ndryshimet në vlerën kontabël bruto të kredive dhe paradhënieve për klientët gjatë periudhës që kontribuoi në ndryshime në provizionin për humbjet, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali
Vlera kontabël, bruto më 1 janar 2021	34,279,195	2,622,432	3,143,529	-	40,045,156
Transferimet:	(69,487)	(100,194)	169,681	-	-
Transferimet: nga Faza 1 në Fazën 2	(1,280,121)	1,280,121	-	-	-
Transferimet: nga Faza 1 në Fazën 3	(62,061)	-	62,061	-	-
Transferimet: nga Faza 2 në Fazën 1	1,264,542	(1,264,542)	-	-	-
Transferimet: nga Faza 2 në Fazën 3	-	(195,575)	195,575	-	-
Transferimet: nga Faza 3 në Fazën 1	8,154	-	(8,154)	-	-
Transferimet: nga Faza 3 në Fazën 2	-	79,801	(79,801)	-	-
Aktive financiare të çregjistruara gjatë periudhës përveç fshirjeve	-	-	-	-	-
Aktive të reja të origjinuara ose të blera	12,505,609	153,764	232,831	-	12,892,204
Disbursimi i ri neto/Pagesat e huasë	(4,123,482)	(526,469)	(907,638)	-	(5,557,589)
Fshirjet	-	-	(105,355)	-	(105,355)
Efekt nga kursi i këmbimit dhe lëvizjet e tjera	(373,864)	(41,102)	(42,105)	-	(457,071)
Vlera kontabël, bruto më 31 dhjetor 2021	42,217,972	2,108,430	2,490,943	-	46,817,344
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali
Vlera kontabël, bruto më 1 janar 2020	26,965,468	2,348,386	3,636,636	-	32,950,490
Transferimet:	916,668	(124,971)	(791,697)	-	-
Transferimet: nga Faza 1 në Fazën 2	170,261	(317,899)	147,638	-	-
Transferimet: nga Faza 1 në Fazën 3	(657,002)	657,002	-	-	-
Transferimet: nga Faza 2 në Fazën 1	(82,542)	-	82,542	-	-
Transferimet: nga Faza 2 në Fazën 3	909,750	(909,750)	-	-	-
Transferimet: nga Faza 3 në Fazën 1	-	(169,596)	169,596	-	-
Transferimet: nga Faza 3 në Fazën 2	55	-	(55)	-	-
Aktive financiare të çregjistruara gjatë periudhës përveç fshirjeve	-	-	-	-	-
Aktive të reja të origjinuara ose të blera	14,743,789	1,230,577	846,335	-	16,820,70
Disbursimi i ri neto/Pagesat e huasë	(8,101,752)	(395,479)	(1,195,045)	-	2
Fshirjet	-	-	(332,605)	-	(9,692,275)
Efekt nga kursi i këmbimit dhe lëvizjet e tjera	501,428	(243,153)	40,569	-	(332,605)
Vlera kontabël, bruto më 31 dhjetor 2020	34,279,195	2,622,432	3,143,529	-	40,045,156

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***20. Huatë dhe paradhëniet për klientët, neto (vazhdim)**

Tabela e ndryshimeve në provizionin për humbjet nga huatë për kompanitë dhe arsyet e këtyre ndryshimeve:

Kompanitë

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Totali
HPK deri më 1 janar 2021	373,069	153,740	1,012,225	1,539,034
Lëvizjet me ndikim në fitim ose humbje				
Transferimet:	93,377	(96,566)	3,189	-
Transferimet: nga Faza 1 në Fazën 2	(11,629)	11,629	-	-
Transferimet: nga Faza 1 në Fazën 3	(4)	-	4	-
Transferimet: nga Faza 2 në Fazën 1	104,250	(104,250)	-	-
Transferimet: nga Faza 2 në Fazën 3	-	(11,001)	11,001	-
Transferimet: nga Faza 3 në Fazën 1	760	-	(760)	-
Transferimet: nga Faza 3 në Fazën 2	-	7,056	(7,056)	-
Aktive të reja financiare të origjinuara ose të blera	45,511	666	33,557	79,734
Ndryshime në PD / HD / ED	(118,811)	64,225	(68,881)	(123,468)
Fshirje	-	-	(193,460)	(193,460)
Totali neto i fitimit ose humbjes gjatë periudhës	20,077	(31,675)	(225,595)	(237,194)
Lëvizje të tjera pa ndikim në fitim ose humbje	(28,022)	7,913	72,696	52,587
HPK më 31 dhjetor 2021	365,123	129,979	859,325	1,354,427

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Totali
HPK deri më 1 janar 2020	259,916	44,420	1,105,597	1,409,931
Lëvizjet me ndikim në fitim ose humbje				
Transferimet:	20,650	(3,424)	(17,226)	-
Transferimet: nga Faza 1 në Fazën 2	(4,222)	4,222	-	-
Transferimet: nga Faza 1 në Fazën 3	(128)	-	128	-
Transferimet: nga Faza 3 në Fazën 1	25,000	(25,000)	-	-
Transferimet: nga Faza 2 në Fazën 1	-	(8,488)	8,488	-
Transferimet: nga Faza 2 në Fazën 3	-	-	-	-
Transferimet: nga Faza 3 në Fazën 2	-	25,842	(25,842)	-
Aktive të reja financiare të origjinuara ose të blera	195,036	104,582	195,764	495,383
Ndryshime në PD / HD / ED	(62,026)	(9,010)	74,949	3,913
Fshirje	-	-	(171,823)	(171,823)
Totali neto i fitimit ose humbjes gjatë periudhës	153,660	92,148	81,664	327,473
Lëvizje të tjera pa ndikim në fitim ose humbje	40,505	(17,171)	175,037	198,372
HPK më 31 dhjetor 2020	454,080	119,397	1,362,399	1,935,879

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***20. Huatë dhe paradhëniet për klientët, neto (vazhdim)****Kompanitë (vazhdim)**

Ndryshimet në vlerën kontabël bruto të huave dhe paradhënieve për kompanitë gjatë periudhës që kontribuoi në ndryshime në provizionimin për humbjen, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Totali
Vlera kontabël, bruto më 1 janar 2021	23,261,395	1,473,354	2,433,856	27,168,605
Transferimet:	(268,792)	243,059	25,733	-
Transferimet: nga Faza 1 në Fazën 2	(1,087,827)	1,087,827	-	-
Transferimet: nga Faza 1 në Fazën 3	(9,746)	-	9,746	-
Transferimet: nga Faza 2 në Fazën 1	826,190	(826,190)	-	-
Transferimet: nga Faza 2 në Fazën 3	-	(42,043)	42,043	-
Transferimet: nga Faza 3 në Fazën 1	2,590	-	(2,590)	-
Transferimet: nga Faza 3 në Fazën 2	-	23,466	(23,466)	-
Aktive të reja financiare të origjinuara ose të blera	7,872,343	126,894	85,892	8,085,129
Rritja/ (Rënia) për shkak të pagesave të huasë/disbursimeve të reja	(2,435,162)	(268,892)	(757,119)	(3,461,173)
Fshirjet	-	-	(81,154)	(81,154)
Efekt nga kursi i këmbimit dhe lëvizjet e tjera	(265,522)	(26,349)	(32,035)	(323,906)
Vlera kontabël, bruto që nga 31 dhjetor 2021	28,164,263	1,548,065	1,675,174	31,387,502

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Totali
Vlera kontabël, bruto më 1 janar 2020	17,979,279	1,616,975	2,928,287	22,524,542
Transferimet:	649,618	(704,091)	54,473	-
Transferimet: nga Faza 1 në Fazën 2	(177,344)	177,344	-	-
Transferimet: nga Faza 1 në Fazën 3	(18,451)	-	18,451	-
Transferimet: nga Faza 2 në Fazën 1	845,413	(845,413)	-	-
Transferimet: nga Faza 2 në Fazën 3	-	(89,294)	89,294	-
Transferimet: nga Faza 3 në Fazën 1	-	-	-	-
Transferimet: nga Faza 3 në Fazën 2	-	53,272	(53,272)	-
Aktive të reja financiare të origjinuara ose të blera	10,257,650	959,891	773,001	11,990,542
Rritja/ (Rënia) për shkak të pagesave të huasë/disbursimeve të reja	(6,049,962)	(147,783)	(1,076,280)	(7,274,025)
Fshirje	-	-	(276,421)	(276,421)
Efekt nga kursi i këmbimit dhe lëvizjet e tjera	424,810	(251,639)	30,796	203,967
Vlera kontabël, bruto që nga 31 dhjetor 2020	23,261,395	1,473,354	2,433,856	27,168,605

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***20. Huatë dhe paradhëniet për klientët, neto (vazhdim)**

Tabela e ndryshimeve në provizionimin për humbjen për kreditë konsumatore dhe arsyet e këtyre ndryshimeve:

Konsumatore

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Totali
HPK deri më 1 janar 2021	56,540	69,032	102,048	227,621
Lëvizjet me ndikim në fitim ose humbje				
Transferimet:	22,092	(24,404)	2,312	-
Transferimet: nga Faza 1 në Fazën 2	(1,614)	1,614	-	-
Transferimet: nga Faza 1 në Fazën 3	(1,227)	-	1,227	-
Transferimet: nga Faza 2 në Fazën 1	23,072	(23,072)	-	-
Transferimet: nga Faza 2 në Fazën 3	-	(7,529)	7,529	-
Transferimet: nga Faza 3 në Fazën 1	1,860	-	(1,860)	-
Transferimet: nga Faza 3 në Fazën 2	-	4,584	(4,584)	-
Aktive të reja financiare të origjinuara ose të blera	28,809	7,482	79,392	115,683
Ndryshime në PD / HD / ED	43,733	(50,962)	(23,437)	(30,665)
Fshirje	-	-	(5,371)	(5,371)
Totali neto i fitimit ose humbjes gjatë periudhës	94,635	(67,884)	52,896	79,647
Lëvizje të tjera pa ndikim në fitim ose humbje	(76,274)	38,657	40,393	2,777
HPK më 31 dhjetor 2021	74,901	39,806	195,337	310,045
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Totali
HPK deri më 1 janar 2020	33,493	14,364	72,080	119,937
Lëvizjet me ndikim në fitim ose humbje				
Transferimet:	1,484	(4,372)	2,889	-
Transferimet: nga Faza 1 në Fazën 2	(999)	999	-	-
Transferimet: nga Faza 1 në Fazën 3	(503)	-	503	-
Transferimet: nga Faza 2 në Fazën 1	2,075	(2,075)	-	-
Transferimet: nga Faza 2 në Fazën 3	-	(4,305)	4,305	-
Transferimet: nga Faza 3 në Fazën 1	910	-	(910)	-
Transferimet: nga Faza 3 në Fazën 2	-	1,009	(1,009)	-
Aktive të reja financiare të origjinuara ose të blera	24,894	31,649	21,800	78,343
Ndryshime në PD / HD / ED	53,252	(77)	24,403	77,578
Fshirje	24,894	31,649	21,800	78,343
Totali neto i fitimit ose humbjes gjatë periudhës	79,629	27,200	24,970	131,799
Lëvizje të tjera pa ndikim në fitim ose humbje	(56,582)	27,468	4,998	(24,115)
HPK më 31 dhjetor 2020	56,540	69,032	102,048	227,621

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)***20. Huatë dhe paradhëniet për klientët, neto (vazhdim)****Konsumatore (vazhdim)**

Ndryshimet në vlerën kontabël bruto të huave konsumatore gjatë periudhës që kontribuan në ndryshime në provizionin për humbjet, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Totali
Vlera kontabël bruto që nga 1 janari 2021	2,811,780	283,374	182,036	3,277,190
Transferimet:	(44,319)	(16,150)	60,469	-
Transferimet: nga Faza 1 në Fazën 2	(84,270)	84,270	-	-
Transferimet: nga Faza 1 në Fazën 3	(40,564)	-	40,564	-
Transferimet: nga Faza 2 në Fazën 1	76,618	(76,618)	-	-
Transferimet: nga Faza 2 në Fazën 3	-	(31,654)	31,654	-
Transferimet: nga Faza 3 në Fazën 1	3,897	-	(3,897)	-
Transferimet: nga Faza 3 në Fazën 2	-	7,852	(7,852)	-
Aktive të reja financiare të origjinuara ose të blera	1,373,682	16,103	92,123	1,481,908
Rritja/ (Rënia) për shkak të pagesave të huasë/disbursimeve të reja	(820,395)	(122,926)	(35,466)	(978,787)
Fshirje			(1,423)	(1,423)
Efektë nga kursi i këmbimit dhe lëvizjet e tjera	(9,387)	(2,301)	(544)	(12,232)
